



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 15	2000	Qershor
--------	------	---------

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr. 8599, datë 10.4.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8270, datë 23.12.1997, "Për kontrollin e Lartë të Shtetit"	699
Ligj nr.8614, datë 25.5.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Unesco-s "Për edukimin ndërkulturor dhe edukimin për të drejtat e njeriut në Shqipëri"	702
Ligj nr.8615, datë 1.6.2000	Për urdhrin e mjekëve në Republikën e Shqipërisë	707
Ligj nr.8616, datë 1.6.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8440, datë 13.1.1999 "Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese nën 20 NRT"	711
Ligj nr.8617, datë 1.6.2000	Për përjashtimin nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak të shtetasve shqiptarë-ushtarë, në periudhën 27 shkurt - 28 mars 1997	712
Dekret nr.2653, datë 15.6.2000	Për lënie të shtetësisë	713

Vendim i KM Nr.82, datë 2.3.2000	Për shpalljen park kombëtar në mbrojtje të shtetit të zonës arkeologjike të Butrintit	714
Vendim i KM Nr.180, datë 13.4.2000	Për shpalljen ansambël monument-kulture të aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës	715
Vendim i KM Nr.207, datë 29.4.2000	Për miratimin e pjesëmarrjes në Fondacionin Shqiptaro-Amerikan "Harry T.Fultz" dhe të aktit të krijimit të këtij fondacioni	716
Vendim i KM Nr.255, datë 27.5.2000	Për miratimin e raportit të vlerësimit të ofertave, për privatizimin e "Albanian Mobile Communications (AMC), sh.a"	728
Vendim i KM Nr.261, datë 25.5.2000	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.317, datë 8.7.1999, "Për shpërblimin e punës së punonjësve"	729
Vendim i KM Nr.262, datë 25.5.2000	Për dhënien e lejes për punë shtetasve të huaj	729
Vendim i KM Nr.263, datë 25.5.2000	Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në statutin e shërbimit kombëtar të punësimit, e miratuar me vendimin nr.42, datë 17.1.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e statutit të shërbimit kombëtar të punësimit"	731
Vendim i KM Nr.266, datë 25.5.2000	Për ndryshimin e emrit zyrtar të Institutit të Lartë të Kulturës Fizike "Vojo Kushi", në Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi"	733
Vendim i KM Nr.269, datë 25.5.2000	Për ndalimin e përdorimit, magazinimit, prodhimit e të transferimit të minave kundër personit dhe shkatërrimit të tyre	734
Vendim i Kuvendit Nr.440, datë 1.6.2000	Për miratimin e statutit të radiotelevizionit Shqiptar (RTSH)	735

L I G J
Nr.8599, datë 10.4.2000

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8270, DATË 23.12.1997 “PËR
KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT”**

Në mbështetje të neneve 81, 83 pika 1, 162-165 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

- Në nenin 1, pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar në Republikën e Shqipërisë”.

Në paragrafin e dytë hiqen fjalët: “Kontrolli i Lartë i Shtetit është një organizëm i pavarur kontrolli i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si vijon:

“Konfliktet e kompetencave midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe institucioneve të tjera shtetërore (publike) zgjidhen nga Gjykata e Apelit.”

Neni 3

Neni 7 ndryshohet si vijon:

“Kontrolli i Lartë i Shtetit në përputhje me kompetencat e tij kontrollon:

- a) veprimtarinë ekonomike e financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë;
- b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe vendor;
- c) veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti;
- ç) përdorimin e fondeve që u janë dhënë nga Buxheti i Shtetit partive politike dhe shoqatave;
- d) mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të kontroll-revizionit të brendshëm shtetëror;
- dh) subjektet e tjera të përcaktuara me ligje të veçanta.”

Neni 4

Neni 11 ndryshohet si vijon:

“Kontrolli i Lartë i Shtetit drejtohet nga Kryetari.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi, me propozimin e Presidentit të Republikës. Ai qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të jetë shtetas shqiptar me arsim të lartë në ekonomi, në financë ose juridik dhe të ketë jo më pak se 10 vjet punë në profesion, të gëzojë një figurë të pastër etiko-morale dhe të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë.

Paga e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.”

Neni 5

Neni 12 ndryshohet si vijon:

“Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit vendos për:

- a) strukturën, organikën dhe emërtimin e funksioneve të Kontrollit të Lartë të shtetit;
- b) kompetencat dhe detyrat e drejtorëve dhe njësisë organizative;
- c) strukturën e pagës dhe shpërblimin e personelit;
- ç) planin vjetor të kontrollit;
- d) standardet e kontrollit;
- dh) buletin;
- e) materiale të cilat i dërgohen prokurorisë për ndjekje penale;
- ë) çështje të cilat do t'i dërgohen gjykatës;
- f) çështje të tjera që i gjykon të nevojshme ose që janë të specifikuar në ligje.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në marrëdhënie me të tjerët, përfaqësohet nga Kryetari dhe në mungesë nga një person i ngarkuar prej tij.”

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë, rreshti i parë, hiqen fjalët “e dy zëvendëskryetarëve”.

- Paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

“Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit fillon detyrën pasi bën betimin përpara Kuvendit.

Formula e betimit është: “Betohem se gjatë kryerjes së detyrave të mia do t'i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe ligjit”.”

Neni 7

Neni 14 ndryshohet si vijon:

“Mandati i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbaron para afatit kur:

jep dorëheqjen;

b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

c) nuk paraqitet në detyrë për më shumë se gjashtë muaj rresht;

ç) deklarohet i paaftë mendërisht për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

d) ngarkohet me një detyrë të papajtueshme me funksionin e tij.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të ndalohej ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi, ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

Me propozimin e Presidentit të Republikës, Kuvendi mund ta shkarkojë Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për shkelje të Kushtetutës, për paaftësi mendore ose fizike dhe për akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin e tij nga detyra.”

Neni 8

Neni 18 ndryshohet si vijon:

“Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit:

a) raportin për zbatimin e buxhetit faktik të shtetit, duke përfshirë konkluzionet e kontrollit me opinionin e vet. Raporti vjetor paraqitet në Kuvend në përputhje me ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”.

Raporti vjetor publikohet në buletin;

b) mendime për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar, para se të miratohet në Kuvend;

c) informacion për rezultatet e kontrollit, sa herë që kërkohen nga Kuvendi.

Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund t'i kërkojë Kuvendit që të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme.”

Neni 9

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

- Në rreshtin e parë, fjala “Kryesia” zëvendësohet me fjalët “Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

- Në fillim të nenit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të ftohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, kur shtrohen çështje që lidhen me funksionet e tij.”

Neni 10

Neni 20 ndryshohet si vijon:

“Punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk duhet të bëjnë pjesë në asnjë organizatë ose parti politike, si dhe nuk duhet të marrin pjesë në veprimtari politike ose me karakter tregtar.

Punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë profesionale në përputhje me standardet e kontrollit dhe normat etike.

Administrimi i shërbimit civil në Kontrollin e Lartë të Shtetit, ngritja në detyrë, lëvizja paralele, vlerësimi, transferimi, lirimi, pezullimi, si dhe masat disiplinore bëhen në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.”

Neni 11

KREU VIII, ANKIMI, neni 21 shfuqizohet.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2647, datë 8.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J

Nr.8614, datë 25.5.2000

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE UNESCO-S “PËR EDUKIMIN NDËRKULTUROR DHE EDUKIMIN PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË SHQIPËRI””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe UNESCO-s “Për edukimin ndërkulturor dhe edukimin për të drejtat e njeriut në Shqipëri””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2641, datë 2.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani.**

MARRËVESHJE PËR EDUKIMIN NDËRKULTUROR DHE PËR EDUKIMIN PËR TË DREJTAT
E NJERIUT NË SHQIPËRI MIDIS ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR
ARSIMIN DHE SHKENCËN (UNESCO) DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe UNESCO
(këtu më poshtë të quajtura “Palë”),

Duke qenë se Qeveria Shqiptare ka kërkuar ndihmën e UNESCO-s për projektin “Edukimi Ndërkulturor dhe Edukimi për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri”,

Duke qenë se Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s është i autorizuar të marrë fonde nga shtetet anëtare, nga organizatat ndërkombëtare, lokale dhe kombëtare me qëllim që të sigurojnë zbatimin e detyrave në përputhje me objektivat, orientimet dhe veprimtaritë e organizatës,

Duke rënë dakord me UNESCO-n, Qeveria e Republikës së Italisë vë në dispozicion të UNESCO-s fonde për të ndihmuar Qeverinë Shqiptare në zbatimin e projektit të përshkruar në aneksin 1 të këtij dokumenti,

Të dyja Palët u morën vesh për sa vijon:

Neni 1

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të kontribuojë për paqen dhe mirëkuptimin në Ballkan, të nxisë bashkëveprimin ndërkulturor dhe respektimin e të drejtave të njeriut në shkollë. Objektivat e afërta të projektit në bazë të kësaj Marrëveshjeje, janë si më poshtë:

a) Të kontribuojë në shtypjen e teksteve shkollore në mënyrë që të nxitet që në vitet e para të shkollës fryma e tolerancës.

b) Të fusë nocionin e përmasave ndërkombëtare dhe ndërkulturore në programet arsimore në nivel zyrtar dhe jozyrtar.

c) Të formojë mësuesit dhe personelin e domosdoshëm për këtë tip edukimi.

2. Një përshkrim i detajuar bëhet në Aneks.

Neni 2

Detyrimet e Qeverisë

Qeveria Shqiptare do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e projektit. Qeveria do të vërë në dispozicion të projektit një funksionar të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe do të mundësojë organizimin e seminareve të formimit.

Neni 3
Detyrimet e UNESCO-s

1. Gjatë periudhës që do të përfshijë projekti dhe në kuadër të kontributit të Qeverisë Italiane, e vlerësuar 339.000 \$ (këtu përfshihen shpenzimet administrative që përbëjnë 13 për qind të kësaj shume), siç tregohet në Aneks, UNESCO:

- a) do të sigurojë me të gjitha mënyrat veprimtaritë e formimit,
- b) do të përgatisë marrëveshjet kontraktore në shërbim të zbatimit të projektit,
- c) do të gjejë mjetet teknike për zbatimin sa më të mirë të këtij projekti.

Ndihma e UNESCO-s, siç është përshkruar në paragrafin e mësipërm (1), do të varet nga derdhja e fondeve nga ana e Qeverisë Italiane dhe do të ndërvaret nga vendimet e Konferencës së Përgjithshme të UNESCO-s; kjo ndihmë do të jepet konform statuteve, rregulloreve dhe metodave të UNESCO-s.

Të gjitha fondet e UNESCO-s, të papërdorura ose jo, të shpenzuara deri në momentin e realizimit të projektit nga Qeveria sipas kësaj Marrëveshjeje, do t'i kthehen UNESCO-s në mënyrë që kjo e fundit t'ia kthejë Qeverisë Italiane.

Neni 4
Materiale dhe pajisje

1. Të gjitha pajisjet dhe materialet e dhëna në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të përdoren vetëm për zbatimin e saj. Materialet jo të konsumueshme, vlera e të cilave për njësi është 1 000 \$, do të mbeten në pronësi të UNESCO-s dhe do të figurojnë në inventarin e saj. Në përfundim të Marrëveshjes, UNESCO do të vendosë për transferimin e titullit të pronësisë së këtij materiali, pas konsultimeve me Qeverinë Shqiptare. Pronësia e të gjitha materialeve dhe pajisjeve të tjera i transferohet Qeverisë në momentin e dorëzimit të tyre në vendin e zbatimit të Marrëveshjes.

2. Në rastin e ndihmës së dhënë nga UNESCO, në formë materialesh dhe pajisjesh, Qeveria do të marrë të gjitha masat e nevojshme për marrjen e tyre në ngarkim, për importimin, zhdoganimin, transportimin, mirëmbajtjen dhe depozitimin e tyre nga pika e hyrjes në territorin shqiptar, deri në vendin e zbatimit të projektit. Gjithashtu, menjëherë pas çuarjes së tyre në destinacion Qeveria do të marrë përsipër ruajtjen, mirëmbajtjen, sigurimin dhe sipas rastit: instalimin dhe montimin e tyre nën drejtimin e ekspertëve të UNESCO-s.

Neni 5
Kushte të tjera

1. Ndihma e UNESCO-s nuk do të ndalojë Qeverinë të marrë ndihma të tjera plotësuese nga institucione të tjera të Kombeve të Bashkuara, programe dypalëshe ose fondacione.

2. Qeveria do t'i japë UNESCO-s informacione mbi ndihmat e kërkuara ose të marra nga këto të fundit.

Neni 6
Informacione dhe raporte

1. Qeveria do t'i japë UNESCO-s informacionet, raportet dhe llogaritë, që UNESCO do t'i kërkojë periodikisht, brenda limiteve të arsyeshme kohore, në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes.

2. Pa e kufizuar rëndësinë e dispozitës së mëparshme, Qeveria do të paraqesë një raport vjetor ku të shpjegojë në detajë veprimet e kryera gjatë periudhës së konsideruar dhe veprimet e parashikuara për periudhën pasuese. Raporti do të shpjegojë vështirësitë e hasura ose vështirësitë e parashikuara dhe do të përmbajë kërkesa veprimi specifike drejtuar UNESCO-s. Përveç kësaj, Qeveria, do të raportojë mbi gjendjen financiare vjetore. Në këtë raport do të futen edhe informacione mbi fondet e marra nga burime të tjera jashtë UNESCO-s për këtë projekt dhe shpenzimet e kryera.

3. Për të inspektuar dhe për të verifikuar natyrën, cilësinë dhe shkallën e zbatimit të projektit, Qeveria do të lejojë UNESCO-n ose përfaqësuesit e saj, të hyjnë në vendet e zbatimit të projektit, si dhe të kontrollojnë dokumentet dhe gjendjen financiare. Këto dokumente do të vihen në dispozicion të

UNESCO-s dhe do të ruhen të pakën 5 vjet pas përfundimit ose shfuqizimit të projektit.

Neni 7

Privilegje dhe imunitete

1. Për funksionarët dhe ekspertët e UNESCO-s, si dhe për të mirat materiale, fondet dhe pasuritë e kësaj organizate, Qeveria do të aplikojë dispozitat e Konventës mbi privilegjet dhe imunitetet e institucioneve të specializuara dhe dispozitat e Aneksit 4 të kësaj Konvente. Do të bihet dakord në mënyrë të veçantë se nuk do të ushtrohet asnjë kufizim ndaj funksionarëve dhe ekspertëve të UNESCO-s, si dhe ndaj personave të tjerë që do të punojnë për llogari të UNESCO-s në kuadrin e zbatimit të këtij projekti, pa dallim kombësie. Gjithashtu nuk do t'u kufizohet e drejta e hyrjes në territorin shqiptar, e qëndrimit dhe e largimit prej tij.

2. Qeveria do të përjashtojë nga të gjitha taksat dhe tarifat materialet, pajisjet dhe shërbimet e tjera në funksion të zbatimit të projektit.

3. Qeveria dhe organet e saj nuk do të imponojë komisionet bankare për transferime fondesh të kryera nga UNESCO.

4. Qeveria do të marrë të gjitha masat për të përjashtuar UNESCO-n, personelin e saj dhe personat e tjerë që punojnë për llogari të saj nga rregulloret dhe dispozitat juridike që mund të përfshijnë veprimet e parashikuara nga kjo Marrëveshje dhe do të përfitojnë lehtësira për të zbatuar sa më shpejt dhe në mënyrë sa më efikase këtë Marrëveshje. Qeveria do t'u akordojë të drejtat dhe lehtësitë e mëposhtme:

a) lëshimin e shpejtë dhe falas të vizave, licencave dhe lejeve të nevojshme;
b) hyrjen në vendet e zbatimit të Marrëveshjes dhe të gjitha lejet e nevojshme të kalimit;
c) lirinë e lëvizjes në brendësi të territorit shqiptar, lirinë e lëvizjes për në destinacionet e përcaktuara nga Marrëveshja dhe lirinë e hyrjes në vend, në mënyrë që të zbatohet sa më mirë Marrëveshja;

d) vlera sa më të favorshme të këmbimit valutor;
e) autorizimet e nevojshme për importimin e materialeve dhe pajisjeve të përmendura në këtë Marrëveshje dhe eksportimin e tyre të mëvonshëm;

f) autorizimet e nevojshme për importimin e të mirave materiale që u përkasin funksionarëve të UNESCO-s ose personave të tjerë që kryejnë shërbime për llogari të saj në rastin kur këto të mira materiale, janë të destinuara për konsumin personal, si dhe eksportimin e tyre të mëtejshëm.

5. Qeveria do t'i përgjigjet çdo ankese të formuluar nga të tretët ndaj UNESCO-s, të mirave të saj materiale, personelit ose personave që kryejnë shërbime për llogari të UNESCO-s. Në rast ankese, ajo do të përjashtojë nga detyrimet ligjore UNESCO-n, të mirat e saj materiale, personelin e saj, si dhe personat e tjerë të cituar më lart dhe do t'i çlirojë nga çdo përgjegjësi që rrjedh nga veprimet e kryera në emër të kësaj Marrëveshjeje, përveç rastit kur UNESCO dhe Qeveria bien dakord që ankesa ose përgjegjësia e përmendur vijnë si rezultat i një neglizhence të rëndë ose të një gabimi të qëllimshëm të këtij personeli ose të personave të tjerë.

Neni 8

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi datën e nënshkrimit. Ajo mund të modifikohet me marrëveshje të shkruar midis UNESCO-s dhe Qeverisë. Secila nga Palët do t'i kushtojë vëmendje çdo propozimi të formuluar nga Pala tjetër me qëllim modifikimin e Marrëveshjes.

2. Kjo Marrëveshje mund të shfuqizohet nga UNESCO dhe nga Qeveria me një njoftim paraprak me shkrim drejtuar Palës tjetër. Shfuqizimi do të ketë efekt nëntëdhjetë (90) ditë pas marrjes së këtij njoftimi, me kusht që ai të mos prekë pjesët e Marrëveshjes që i përkasin përgjegjësisë të marra në mirëbesim nga secila Palë në Marrëveshje, para shfuqizimit të saj.

3. Detyrimet e marra nga UNESCO dhe Qeveria bazuar në këtë Marrëveshje do të mbeten në fuqi pas mbarimit të vlefshmërisë ose shfuqizimit të saj, për aq kohë sa do të bëhet tërheqja e personelit, e fondeve dhe e të mirave materiale të UNESCO-s dhe rregullimi i llogarive midis Palëve.

I pranuar në emër të Palëve dhe nënshkruar

Për UNESCO-n
B.Duvieusaart
Drejtore i Zyrës së Marrëdhënieve me
Burimet e Financimit Ekstrabuxhetor

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Ethem Ruka
Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Datë 12 maj 1999

Datë 7.12.1999

ANEKS

PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT TË PROPOZUAR

Titulli: Edukimi Ndërkulturor dhe Edukimi për të drejtat e Njeriut në Shqipëri,
Kohëzgjatja: 2 vjet
Agjencia Zbatuese: UNESCO, Sektori i Edukimit Human, Kulturor dhe Ndërkombëtar,
Agjenci Qeveritare: Ministrinë e Arsimit dhe Komisionet Kombëtare të UNESCO-s.
Buxheti total: 339 000 \$ dollarë.

L I G J **Nr.8615, datë 1.6.2000**

PËR URDHRIN E MJEKËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË **V E N D O S I:**

KREU I **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë është ent publik, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të profesioneve mjekësore dhe rregullon marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut.

Neni 2

Urdhri i Mjekëve përbëhet nga mjekët e stomatologët që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë dhe që përmbushin kushtet për të qënë anëtarë sipas këtij ligji.

Anëtarë të Urdhrit të Mjekëve bëhen mjekët e stomatologët, shtetas shqiptarë, të diplomuar në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj dhe që pranojnë Kodin Deontologjik Mjekësor Shqiptar.

Përjashtohen nga ky detyrim, por jo nga e drejta e anëtarësimit në këtë organizëm, mjekët funksionarë të administratës shtetërore, për sa kohë që ata nuk ushtrojnë veprimtari të mirëfilltë profesionale mjekësore ose shëndetësore.

Neni 3

Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e mjekut ose të stomatologut në Republikën e

Shqipërisë pa qenë anëtar i Urdhrit të Mjekëve. Punëdhënësit në institucionet shëndetësore publike e private ndalohen t'i punësojnë ata në kundërshtim me këtë dispozitë.

Shtetasit e huaj, për ushtrimin e profesionit të mjekut ose stomatologut në Republikën e Shqipërisë, detyrohen të anëtarësohen paraprakisht në Urdhrin e Mjekëve të Republikës së Shqipërisë, të njohin dhe të zbatojnë Kodin Deontologjik Mjekësor Shqiptarë, si dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë shërbimin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve përcakton kriteret e pranimit të tyre në këtë Urdhër.

Neni 4

Misioni i Urdhrit të Mjekëve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesioneve mjekësore dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i mjekësisë.

Në përmbushje të këtij misioni Urdhri i Mjekëve:

a) kryen regjistrimin dhe mban të azhurnuar regjistrin e mjekëve për ushtrimin e profesionit të tyre;

b) mbikëqyr zbatimin e detyrave profesionale në përputhje me kërkesat e shkencave mjekësore, rregullat e etikës dhe Kodin Deontologjik Mjekësor;

c) siguron udhëheqjen etiko- morale e deontologjike të bashkësisë së mjekëve e të stomatologëve, pavarësinë e ushtrimit të profesionit mjekësor sipas standardeve dhe mbron interesat moralë të këtij profesioni;

ç) mbron interesat e të sëmurëve dhe publikut nga kequshtrimi i mjekësisë dhe shkeljet e Kodit Deontologjik Mjekësor;

d) bashkëpunon për sigurimin e zhvillimit progresiv të standardeve profesionale në shërbimet mjekësore, për planifikimin dhe hartimin e programeve të formimit mjekësor, të specializimit pasuniversitar dhe të edukimit e kualifikimit të vazhdueshëm të mjekëve;

dh) jep dhe heq të drejtën individuale për ushtrimin e profesionit.

Neni 5

Urdhri i Mjekëve, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje sipas përkatësisë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe organe të tjera të shëndetësisë në qendër e në rrethe, si dhe me ministrinë, institucionet qendrore dhe me organizma të tjera shtetërore dhe joshetërore.

Urdhri i Mjekëve merr pjesë në hartimin e ligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme të shëndetësisë shqiptare.

Neni 6

Urdhri i Mjekëve ka buxhetin e tij, të cilin e administron vetë në përputhje me rregullat financiare në fuqi. Burimet financiare të Urdhrit të Mjekëve janë:

a) Kuotizacionet e anëtarëve.

b) Tarifat e Regjistrimit dhe të dhënies të së drejtës individuale për ushtrimin e profesionit.

c) Donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

Të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Urdhri i Mjekëve i përdor për të përmbushur misionin e tij të caktuar në këtë ligj.

KREU II ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 7

Organet kryesore të Urdhrit të Mjekëve janë:

a) Asambletë;

b) Këshillat;

c) Komisionet disiplinore;

ç) Komisioni i Regjistrimit dhe i Dhënies të së Drejtës së Ushtrimit të Profesionit.

Neni 8

Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga tërësia e anëtarëve të këshillave rajonalë. Asambleja e Përgjithshme zgjedh Këshillin Kombëtar.

Zgjedhjet e Këshillit Kombëtar bëhen çdo 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Asambleja rajonale përbëhet nga tërësia e përfaqësuesve të anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve të rajonit (qarkut). Asambleja rajonale zgjedh këshillin rajonal.

Zgjedhjet e këshillit rajonal bëhen çdo 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 9

Në Këshillin Kombëtar bëjnë pjesë detyrimisht: Presidenti i Urdhrit të Mjekëve, zëvendësit e tij, presidentët e këshillave rajonalë dhe nga një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë, i Ministrisë së Drejtësisë, i Ministrisë së Punës dhe i Çështjeve Sociale, i Ministrisë së Financave, i Akademisë së Shkencave, i Fakultetit të Mjekësisë, i Fakultetit të Shkencave Sociale, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe i Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor.

Rastet e shkarkimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar parashikohen në Statutin e Urdhrit të Mjekëve.

Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin dhe zëvendësit e tij. Mandati i Presidentit është 6-vjeçar me të drejtën e një rizgjedhjeje. Funksioni i tij është i papajtueshëm me funksione të tjera drejtuese të administratës shtetërore. Ky Këshill emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm.

Vendimet e Këshillit Kombëtar merren me shumicë votash, kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

Neni 10

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve harton Kodin e Deontologjik Mjekësor.

Neni 11

Veprimtaria e Urdhrit të Mjekëve rregullohet me Statutin e vet, i cili hartohet nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve.

Neni 12

Këshillat rajonalë krijohen sipas ndarjes administrative-territoriale në bazë prefekturë (qarku).

Këshilli rajonal zgjedh Presidentin dhe zëvendësit e tij. Mandati i Presidentit është 6 vjet, me të drejtën e një rizgjedhjeje.

Këshilli rajonal emëron dhe shkarkon sekretarin e tij.

Neni 13

Pranë Këshillit Kombëtar dhe këshillave rajonalë të Urdhrit të Mjekëve funksionojnë komisionet disiplinore, të cilat caktohen nga këshillat përkatës.

Komisionet disiplinore janë organizma të gjykimit profesional. Ato verifikojnë dhe shqyrtojnë ankesat për shkeljet e etikës mjekësore, të Kodit Deontologjik, si dhe gabimet mjekësore nga anëtarët e Urdhrit të Mjekëve.

Komisionet disiplinore pranë këshillave rajonalë ushtrojnë kompetenca disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre janë të apelueshme në Komisionin Disiplinor të Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë.

Neni 14

Komisioni Disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara në seancë dëgjimore. Kur vërteton se anëtari ka kryer shkelje të etikës mjekësore, të Kodit Deontologjik ose ka bërë gabim mjekësor, ai jep këto masa:

- a) Vërejtje me shkrim.
- b) Vërejtje me paralajmërim.
- c) Gjobë nga 1 000 deri 100 000 lekë.
- ç) Propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore.
- d) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Mjekëve, deri në 3 vjet.
- dh) Përrjashtim i përkohshëm nga Urdhri i Mjekëve për një periudhë deri në 3 vjet.

Përveç masave të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, si masë plotësuese, Komisioni ka të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese.

Masat e mësipërme disiplinore mund të shlyhen, në qoftë se brenda 1 viti nga dita e dhënies së tyre për shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni dhe brenda 3 vjetësh nga data e dhënies së tyre për shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

Neni 15

Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore paraqiten në Komisionin Disiplinor të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve, brenda 30 ditëve nga komunikimi me shkrim i vendimit.

Komisioni Disiplinor, brenda 60 ditëve nga marrja e ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i Komisionit Disiplinor të Këshillit Kombëtar është i formës së prerë.

Për masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “dh” të nenit 14 të këtij ligji, personi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

KREU III
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 16

Urdhri i Mjekëve për një periudhë trevjeçare subvencionohet nga shteti. Masa dhe mënyra e këtij subvencionimi përcaktohet me akte nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave.

Neni 17

Ligji nr.7708, datë 18.5.1993 “Për krijimin e Urdhrit të Mjekëve”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2644, datë 8.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani.**

L I G J
Nr.8616, datë 1.6.2000

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8440, DATË 13.1.1999 “PËR
REGJISTRIMIN, MËNYRËN E PËRDORIMIT DHE KONTROLLIN E MJETEVE
LUNDRUESE NËN 20 NRT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8440, datë 13.1.1999 “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese nën 20 NRT” bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Neni 6 formulohet si më poshtë:

“Ndalohet regjistrimi dhe përdorimi i mjeteve lundruese të konstruktura, me shpejtësi mbi 20 milje në orë dhe me fuqi motorike mbi 70 kuaj fuqi, me përjashtim të motobarkave që shërbejnë për peshkim.”

Neni 2

Neni 9 formulohet si më poshtë:

“Për çdo mjet lundrimi, i cili kalon 2 milje nga bregu i detit dhe 0.2 milje për Kanalin e Korfuzit, drejtuesi i mjetit duhet të njoftojë kapitenerinë e portit më të afërt, jo më pak se 24 orë përpara dhe të konfirmojë dy orë përpara çdo veprimi për zhvendosjen e mjetit, për vendin e ridislokimit, për kohën e nisjes dhe të kthimit dhe për vendin ku do të kryejë veprimtarinë.”

Mënyrat dhe kodet e komunikimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Transportit.

Neni 3

Në nenin 10, pas paragrafit të katërt, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur mjeti lundrues kapet në tokë dhe është në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në nenet 2, 3, paragrafi i tretë i nenit 4, 6 dhe 8 të këtij ligji, pronari ose drejtuesi i mjetit dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë dhe mjeti lundrues, objekti i kundërvajtjes administrative, sekuestrohet.”

Neni 4

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë ilegale për prodhimin ose riparimin e mjeteve lundruese, objekti i këtij ligji. Ndaj kundërvajtësit merret masa e sekuestrimit të lokalit dhe të mjeteve të prodhimit.”

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2645, datë 8.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani.**

L I G J **Nr.8617, datë 1.6.2000**

PËR PËRJASHTIMIN NGA SHËRBIMI I DETYRUESHËM USHTARAK TË SHTETASVE SHQIPTARË – USHTARË, NË PERIUdhËN 27 SHKURT - 28 MARS 1997

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË **V E N D O S I:**

Neni 1

Shtetasit shqiptarë, që në periudhën 27 shkurt – 28 mars 1997 ishin të inkuadruar në njësitë dhe në repartet e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë si ushtarë në shërbimin e detyrueshëm ushtarak dhe që pas kësaj periudhe nuk e kanë kryer ose po e kryejnë kohën e mbetur të këtij shërbimi, përjashtohen nga ky detyrim.

Neni 2

Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të përfundojë dokumentacionin për shtetasit shqiptarë që përjashtohen nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak, sipas nenit 1 të këtij ligji, brenda datës 30 shtator 2000.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Shpallur me dekretin nr.2646, datë 8.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

DEKRET
Nr.2653, datë 15.06.2000

PËR LËNIE SHTETËSIE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 05.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

I hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij qytetarit:

1. Flamur Ymer Eller (Abdushi).

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

D E K L A R A T Ë

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë shpreh shqetësimin dhe indinjatën më të thellë për fatin e mijëra shqiptarëve të Kosovës të marrë peng në Serbi, gjatë fushatës së spastrimit etnik:

Duke konstatuar se nga e gjithë Kosova mungojnë pa gjurmë mijëra njerëz (vetëm nga Komuna e Gjakovës figurojnë të tillë mbi 720 vetë) dhe se autoritet serbe nuk bëjnë të njohur identitetin e personave të marrë peng;

Duke ditur se në burgjet dhe kampet serbe, pengjet shqiptare u nënshtrohen torturave fizike e psikike;

Duke marrë dijeni për dënimet me burgime të rënda të qindra njerëzve me procese kolektive, politike pa asistencë juridike dhe nën akuza tërësisht absurde;

Duke e konsideruar të gjithë këtë krim të rëndë ndaj njerëzimit, në vijim të krimeve të zbuluara në varrezat kolektive deri tani në Kosovë;

Duke ditur se, mbajtja, torturimi dhe dënimet me burgime të rënda të pengjeve shqiptare i shërben Milosheviçit për ndezjen e konflikteve etnike dhe destabilizimin e Kosovës dhe gjithë rajonit;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë u kërkon Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Europës dhe OSBE-së, të ushtrojnë autoritetin e tyre për fillimin e menjëhershëm të hetimeve mbi sa më sipër dhe të detyrojnë Beogradin;

Të japë të dhëna të plota për shqiptarët e marrë peng, të ndalojë proceset politike dhe të bëjë lirin e menjëhershëm të tyre.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ia drejton këtë deklaratë edhe Kongresit Amerikan dhe parlamenteve të Europës.

Kuvendi i kërkon Qeverisë Shqiptare të intensifikojë përpjekjet pranë qeverive të Bashkimit Europian dhe SHBA-së, si dhe pranë organizmave ndërkombëtarë për ndërhyrje të menjëhershme.

Tiranë, më 1 qershor 2000

V E N D I M
Nr.82, datë 2.3.2000

**PËR SHPALLJEN PARK KOMBËTAR NË MBROJTJE TË SHTETIT TË ZONËS
ARKEOLOGJIKE TË BUTRINTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen Park Kombëtar në mbrojtje të shtetit, zonën arkeologjike të Butrintit, me sipërfaqe 25 km², të shtrirë në këta kufij gjeografikë:

Në veri kufizohet me fshatin Ksamil;

Në jug me lumin e Pavllos, duke anashkaluar Vrinën, drejt fushës dhe duke u futur brenda zonës te liqeni i Bufit;

Në perëndim me gjirin e Butrintit, aty ku kanali i Vivarit derdhet në det;

Në lindje me rrugën ekzistuese, që shkon në Konispol (sipas hartës që i bashkëlidhet vendimit).

2. Për administrimin e këtij Parku Kombëtar ngarkohet Zyra e Administrimit dhe Koordinimit, e qytetit antik të Butrintit, njësi nën juridiksionin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Ky vendim nuk cënon afatet e parashikuara për realizimin e projektit turistik brendashkruar kufijve, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.180, datë 13.4.2000

**PËR SHPALLJEN ANSAMBLË MONUMENT- KULTURE TË AKSIT KRYESOR DHE
QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 16, të ligjit nr.7867, datë 12.10.1994, “Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpallet “Ansamblë monument-kulture”, aksi qendror dhe qendra historike e qytetit të Tiranës, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kufijtë e këtij ansambli janë: Nga sheshi përpara stacionit të trenit, përgjatë shtetitores “Dëshmorët e Kombit”, deri prapa hotel Tiranës”. Vazhdon përgjatë rrugës “U. Pano”, deri në kryqëzimin me “Rrugën e Barrikadave”. Përgjatë “rrugës së Barrikadave”, deri në kryqëzimin e saj me rrugën “Punëtorët e Rilindjes”. Përgjatë rrugës “Punëtorët e Rilindjes” deri tek “Ura e Tabakëve”. Përgjatë bulevardit “Zhan D’Ark” deri tek ura e “Rrugës së Elbasanit”. Kalon urën dhe vazhdon në bulevardin “Bajram Curri” deri në kryqëzimin me rrugën “Lek Dukagjini”. Përgjatë rrugës “Lek

Dukagjini” deri te stadiumi “Qemal Stafa”. Përgjatë rrugës që përfshin stadiumin “Qemal Stafa”, duke përfshirë 100 m thellësi në jug të rrugës përpara Universitetit Politeknik, deri te sheshi përpara Gardës së Republikës. Nga sheshi përpara Gardës së Republikës, përgjatë rrugës “Dëshmorët e 4 shkurtit” deri në kryqëzimin me “Rrugën e Kavajës”. Përgjatë “Rrugës së Kavajës” deri te sheshi në krah të “Lidhjes së Shkrimtarëve”. Nga ky shesh përgjatë rrugës “Kajo Karafili” deri në kryqëzimin me rrugën “Ded Gjo Luli”. Përgjatë rrugës “Ded Gjo Luli” deri në daljen në shëtitoren “Dëshmorët e Kombit”. Përgjatë shëtitores “Dëshmorët e Kombit” deri te sheshi përpara stacionit të trenit.

3. Të gjitha ndërtimet e përkohshme apo të përhershme, të paligjshme, të hiqen brenda fundit të vitit në vazhdim, sipas një plani të specifikuar ndërhyrjeje.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Punëve Publike që, në bashkëpunim me institucionet e specializuara, të realizojnë projektin për ruajtjen dhe restaurimin e elementeve përbërës të ansamblit të mësipërm, në përgjithësi.

5. Për bashkërendimin dhe zbatimin e këtij projekti krijohet grupi i punës, me 3-5 anëtarë, të cilët caktohen nga Kryeministri.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr 207, datë 29.4.2000

**PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES NË FONDACIONIN SHQIPTARO-AMERIKAN
“HARRY T.FULTZ” DHE TË AKTIT TË KRIJIMIT TË KËTIJ FONDACIONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të miratojë pjesëmarrjen e qeverisë së Republikës së Shqipërisë në krijimin e fondacionit shqiptaro-amerikan “Harry T.Fultz” së bashku me fondacionin shqiptaro-amerikan të arsimit “Harry T.Fultz”, të shtetit të Virxhinias, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
2. Kontributi i qeverisë shqiptare të jenë pronat e paluajtshme, trualli dhe ndërtesat e identifikuar në planimetrinë që i bashkëlidhet vendimit, me numrat 8/115, 8/116, 8/117 dhe 8/118, të vendosura nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Tiranë, duke përfshirë shkollën elektrike dhe godinën e saj, dhe dhomat sportive të shkollës teknike “Harry T.Fultz”.
3. Kontributi i fondacionit shqiptaro-amerikan të arsimit “Harry T.Fultz”, i shtetit të Virxhinias, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është investimi në veprimtaritë dhe në burimet arsimore, si dhe angazhimin e tij në rritjen e mëtejshme për zhvillimin e programeve dhe të veprimtarisë arsimore të saj.
4. Miratimin e aktit të krijimit të fondacionit shqiptaro-amerikan “Harry T.Fultz”, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Akti i themelimit të Fondacionit
“Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Arsimit Teknik Harry
T.Fultz”

(Projekt 2/12/99)

Neni 1

Emri i Fondacionit

Emri i këtij fondacioni është “Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Arsimit Teknik Harry T.Fultz” (më poshtë Fondacioni).

Neni 2

Zyra qendrore e Fondacionit

Zyra qendrore e Fondacionit është në Tiranë me adresë _____

Neni 3

Natyra e veprimtarisë së Fondacionit

Natyra e veprimtarisë dhe objektet e qëllimet e propozuara për t’u realizuar, zhvilluar dhe vënë në jetë dhe të gjitha gjërat e përmendura këtu janë për t’u bërë në të njëjtën mënyrë dhe masë që mund të bëheshin ose do të bëheshin nga çdo person fizik vetëm me kusht që ky aktivitet është jo fitim prurës.

Fondacioni mund të ndërmarrë, brenda kufijve të përcaktuara nga qëllimet, çdo veprim ose akt të ligjshëm të lejuar për fondacionet nga legjislacioni shqiptar.

Fondacioni nuk mund të ketë kapital të vetin.

Neni 4

Qëllimi dhe misioni i Fondacionit

Qëllimi i Fondacionit është të mbikqyrë qeverisjen dhe menaxhimin e Shkollës Teknike Harry T.Fultz, si vazhduese historike e Shkollës Profesionale Shqiptare, krijuar në Tiranë nga Kryqi i Kuq Amerikan, programet dhe mjetet e saj, si një institucion privat jo fitim-prurës i arsimit teknik, që i është dedikuar trainimit dhe përgatitjes së teknikëve e profesionistëve në fushat e teknikës ku të gjitha fondet e fituara të përdoren për infrastrukturën, programet e shkollës, shërbimet ndaj shkollës e komunitetit dhe përmirësimin e mundësive të frekuentimit për studentët që janë në disavantazh për shkak të pengesave ekonomike, gjinore, sociale dhe të metave fizike e mendore.

Një Fondacion i tillë është organizuar ekskluzivisht për qëllime bamirësie, arsimore ose shkencore, duke përfshirë qëllimet e përkrahura këtu.

Neni 5

Themeluesit

Dy palët, që veprojnë si themelues të përbashkët, me qëllim për krijimin e një institucioni të fortë për trainimin teknik për rritjen e produktivitetit dhe prosperitetit të Shqipërisë, janë:

1) Qeveria e Republikës së Shqipërisë e cila sjell në këtë themelim, bazuar në ligjin shqiptar dhe me vendim të Këshillit të Ministrave, pronat e paluajtshme që do të përbëjnë vendin operues të Shkollës Teknike Harry T.Fultz dhe,

2) Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Arsimit Harry T.Fultz i Shtetit të Virgjinias në Shtetet e Bashkuara, i regjistruar si agent i ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, i cili sjell në këtë themelim investimet e tashme e të shkuara në aktivitetet dhe burimet arsimore të Shkollës Teknike Harry T.Fultz dhe angazhimin e tij në rritjen e mëtejshme e zhvillimin e programeve dhe aktiviteteve arsimore të saj.

Emri dhe adresa e themeluesve është:

_____ dhe _____

Neni 6

Kompetencat dhe të drejtat e themeluesve

Kompetencat dhe të drejtat e themeluesve marrin fund me bërjen e kërkesës për themelim dhe kur janë caktuar personat që do të shërbejnë si drejtorë të Bordit të Drejtorëve.

Neni 7

Subjektet emëruese të Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve dhe numri i Drejtorëve që ato mund të emërojnë.

Subjektet emëruese të Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve që mund të emërojnë ose shkarkojnë drejtorët, numri i Drejtorëve që ato mund të emërojnë dhe kohëzgjatja në detyrë janë si më poshtë:

1. Një Drejtor i emëruar nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan të Arsimit Harry T.Fultz (i emëruari i parë shërben për një vit, të emëruarit pasues shërbejnë për dy vjet)
2. Një Drejtor i emëruar nga Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri (i emëruari i parë shërben për tre vjet, të emëruarit pasues shërbejnë për dy vjet)
3. Një Drejtor i emëruar nga Ministri i Arsimit të Republikës së Shqipërisë (i emëruari i parë shërben për tre vjet, të emëruarit pasues shërbejnë për dy vjet)
4. Një Drejtor i emëruar nga Ministri i Punës të Republikës së Shqipërisë (i emëruari i parë shërben për tre vjet, të emëruarit pasues shërbejnë për dy vjet)
5. Një Drejtor i emëruar nga Drejtori për Shqipërinë i Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (i emëruari i parë shërben për dy vjet, të emëruarit pasues shërbejnë për dy vjet)
6. Një Drejtor i emëruar nga Drejtori për Shqipërinë i Korporatës Ndërkombëtare të Financës. (i emëruari i parë shërben për tre vjet, të emëruarit pasues shërbejnë për dy vjet)
7. Një Drejtor i emëruar nga Presidenti i Shkollës Bujqësore Amerikane të Selanikut, Greqi (i emëruari i parë shërben për tre vjet, të emëruarit pasues shërbejnë për dy vjet)
8. Tre Drejtorë specialistë ndërkombëtarë të Arsimit Teknik të emëruar nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Arsimit Harry T.Fultz (një nga të emëruarit e parë shërben për dy vjet dhe dy të emëruarit e parë shërbejnë për tre vjet, të emëruarit pasues shërbejnë për dy vjet)
9. Një Drejtor i emëruar si përfaqësues i zgjedhur i Komunitetit Kombëtar Shqiptar të Biznesit. (i emëruari i parë shërben për tre vjet, të emëruarit pasues shërbejnë për dy vjet)

Numri Total i drejtorëve të Bordit të Drejtorëve është 11 (njëmbëdhjetë)

Neni 8

Administratori i Përkohshëm

Përfaqësuesi në Shqipëri i Fondacionit Shqiptaro-Amerikan të Arsimit Harry T.Fultz, me zyra në Shkollën Teknike Harry T.Fultz, do të shërbejë si Administrator i Përkohshëm në emër të Bordit të Drejtorëve, me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë ligjore të Bordit të Drejtorëve, deri në momentin që Bordi i Drejtorëve, do të zgjedhë organet ekzekutive të Fondacionit.

Neni 9

Bordi i Drejtorëve

Aktivitetet dhe veprimtaria e Fondacionit do të menaxhohen nga një Bord i Drejtorëve. Numri i drejtorëve që do të përbëjnë Bordin do të jetë i tillë që të fiksohet në kohë, ose në mënyrën e përshkruar në Statut, por në asnjë rast ky numër nuk do të jetë më i vogël se një. Bordi i Drejtorëve do

të emërohet në mënyrën e përshkruar në Statut në mbledhjen vjetore të Fondacionit që do të mbahet në datën që e parashikon Statuti, dhe do të mbajnë postin deri në emërimin dhe kualifikimin e pasuesve respektivë të tyre. Statuti do të përcaktojë numrin e drejtorëve që nevojiten për mbajtjen e një mbledhje (kuorumin).

Bordi i Drejtorëve është shprehimisht i autorizuar të ndryshojë, ose të anullojë Statutin e këtij Fondacioni.

Neni 10

Delegimi i Fuqive të Bordit

Bordi i Drejtorëve mund të marrë vendim me një shumicë të thjeshtë të të gjithë Bordit, për krijimin e një ose më shumë komiteteve të cilat në masën e përcaktuar nga vendimi i Bordit, ose nga Statuti do të kenë dhe mund të ushtrojnë të gjitha fuqitë e Bordit të Drejtorëve në menaxhimin e aktiviteteve dhe çështjeve të Fondacionit. Ato për më shumë, mund të kenë edhe fuqinë e autorizimit të vendosjes së vulës së korporatës në të gjitha dokumentat që mund ta kërkojnë atë, dhe komiteti ose komitete të tilla do të kenë emër ose emra të tillë që mund të deklarohen në Statutin e Fondacionit ose që mund të përcaktohen kohë pas kohe me vendim të Bordit të Drejtorëve. Sipas përcaktimit në Statut, kohëzgjatja në detyrë e Drejtorëve të Bordit, mund të specifikohet. Fondacioni mund të zgjedhë zyrtarë të tillë, të specifikuar nga Statuti dhe subjekt i kushteve të Statutit, të cilët do të kenë tituj dhe do të ushtrojnë detyra të tilla që përcaktohen nga Statuti. Ky Fondacion në Statutin e tij, mund t'i japë fuqi Bordit të Drejtorëve përveç fuqive dhe autoriteteve që shprehimisht u jepen nga Statuti.

Neni 11

Vendi i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve dhe mbajtja e dokumentave të Fondacionit

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve mund të mbahet jashtë Republikës së Shqipërisë nëse kjo përcaktohet në statut. Dokumentat e Fondacionit mund të mbahen (subjekt i kushteve që përmban Statuti) jashtë Republikës së Shqipërisë në një vend ose vende të tilla që mund të përcaktohen kohë pas kohe nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 12

Përdorimi i të ardhurave të Fondacionit

Asnjë pjesë e të ardhurave neto të Fondacionit nuk mund të shkojë në përfitim të ose të ndahet midis drejtorëve, zyrtarëve të saj ose personave të tjerë privatë, përveç rastit kur Fondacioni do të autorizohet për pagimin e një shpërblimi të arsyeshëm për shërbimet e përfituara për bërjen e pagesave dhe shpërndarjeve për avancimin e qëllimeve të renditura në Nenin 4 më lart. Bërja e propagandës ose çdo ndërhyrje tjetër (duke përfshirë publikimin ose shpërndarjen e deklaratave) në çdo një prej këtyre artikujve, nuk do të përbëjë ndonjë pjesë të konsiderueshme në aktivitetet e Fondacionit. Fondacioni nuk do të realizojë ndonjë aktivitet tjetër që nuk lejohet të realizohet nga një person juridik jo fitim prurës bamirës, arsimor e shkencor.

Neni 13

Shpërndarja e Fondacionit

Në rast shpërndarje të Fondacionit, Bordi i Drejtorëve pas plotësimit të kushteve për pagimin e të gjitha detyrimeve të Fondacionit, do të paraqes propozimin për të ardhmen e shkollës, subjekt i aprovimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Neni 14

Bërja e ndryshimeve në aktin e themelimit

Fondacioni rezervon të drejtën e përmirësimit, ndërrimit, ndryshimit ose anulimit të çdo kushti që përmbahet në këtë Akt Themelimi, në mënyrën e përshkruar tani ose pas kësaj nga Statuti.

Neni 15

Përgjegjësia e Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve

Drejtorët e Bordit të Drejtorëve nuk janë përgjegjës ndaj Fondacionit ose zyrtarëve të tij për dëme në para ose shkelje të detyrave që u janë besuar përveç rastit kur shkelja ka të bëjë me (1) detyrimin e besnikërisë së Drejtorit ndaj Fondacionit; (2) veprime ose mosmarrëveshje në keqbesim ose që kanë të bëjnë me sjellje qëllimisht të gabuara ndaj një thyerje me vetëdije të ligjit; (3) një transaksion prej të cilit drejtori ka një përfitim personal jo korrekt.

UNË I NËNSHKRUARI duke qënë një prej themeluesve të përmendur këtu, bëj këtë Akt Themelimi me qëllimin e krijimit të një Fondacioni jo fitim-prurës në përputhje me Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, duke deklaruar dhe vërtetuar se faktet e paraqitura janë të vërteta dhe në përputhje me këtë lëshoj firmën time më _____ Dhjetor 1999

(Firma e Themeluesit)

(Firma e Themeluesit)

STATUTI I

“Fondacionit Shqiptaro-Amerikan të Arsimit Teknik Harry T.Fultz”
(Projekt 2/12/99)

ZYRAT

Neni 1

Zyra Qendrore e Fondacionit

Zyra qendrore e Fondacionit do të vendoset në Tiranë me adresë _____, Republika e Shqipërisë.

Neni 2

Zyrat e tjera të Fondacionit

Fondacioni mund të ketë gjithashtu zyra në vende të tilla brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, që mund të përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve kohë pas kohe ose që mund të kërkohen prej veprimtarisë së Fondacionit.

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE

Neni 3

Mbledhjet vjetore të Bordit të Drejtorëve

Mbledhjet vjetore të Bordit të Drejtorëve për njohjen e drejtorëve të emëruar dhe zgjedhjen e drejtorëve të zgjedhur të Bordit të Drejtorëve dhe për çështje të tjera të tilla që mund të deklarohen në njoftimin për mbledhjen, ose që mund të dalin gjatë mbledhjes do të mbahen në vende të tilla brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Koha, data dhe vendi i mbledhjes vjetore të Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve, me vendim përcakton, kohën, datën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes. Në rast se Bordi i Drejtorëve nuk përcakton në këtë mënyrë kohën, datën dhe vendin e mbledhjes, mbledhja vjetore e Bordit të Drejtorëve do të mbahet në zyrën qendrore të Fondacionit në Tiranë, në orën 09:00, të hënën e parë të muajit Prill të çdo viti. Nëse data e mbledhjes vjetore bie në një ditë

zyrtare pushimi, mbledhja do të bëhet në ditën e punës pasuese.

Neni 5

Mbledhjet e tjera të Bordit të Drejtorëve

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve për çdo qëllim tjetër përveç zgjedhjes së drejtorëve mund të mbahet në kohë dhe në vend të tillë brenda ose jashtë Shqipërisë, sipas deklarimit në njoftimin për mbledhjen.

Neni 6

E drejta e votës

Çdo anëtar i Bordit të Drejtorëve me të drejtë vote në përputhje me kushtet e Aktit të Themelimit dhe këtij Statuti, do të kenë të drejtën e një vote në person, me fax, komunikim elektronik ose me prokurë.

Neni 7

Procedura, mënyra e votimit dhe marrja e vendimeve

Me kërkesën e çdonjërit prej drejtorëve, votimi për çfarëdo çështje mund të bëhet i fshehtë.

Vendimet për zgjedhjen e drejtorëve të zgjedhur të Bordit të Drejtorëve, emërimin e zyrtarëve, ndryshimet në Statut dhe çështjet e politikave, do të merren me një shumicë votash prej dy të tretash të të gjithë drejtorëve aktualë, me jo më pak se gjashtë vota në favor.

Të gjitha çështjet e tjera operacionale do të vendosen me shumicë të thjeshtë të të gjithë drejtorëve aktualë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga Akti i Themelimit, ose ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Vërtetimi i listës së drejtorëve të Bordit të Drejtorëve

Zyrtari që mban dokumentat e Fondacionit, të paktën 15 ditë para çdo mbledhje të drejtorëve do të përgatisë dhe qarkullojë te drejtorët një listë të kompletuar të adresuar sipas rendit alfabetik të drejtorëve me të drejtë vote në zgjedhjen që vijon. Lista e përmendur do të jetë e hapur për ekzaminimin nga çdo drejtor, për një periudhë të paktën 15 ditore para mbledhjes, në një vend brenda qytetit ku do të mbahet mbledhja, vend që do të specifikohet në njoftimin e mbledhjes ose në rast se nuk specifikohet në vendin ku do të mbahet mbledhja. Lista do të jetë e disponueshme për shqyrtim në mbledhje.

Neni 9

Kuorumi

Përveç rasteve kur në ligj, në Aktin e Themelimit, ose në këtë Statut parashikohet ndryshe, prezenca në person ose me prokurë e shumicës së gjithë drejtorëve aktualë të Bordit të Drejtorëve do të përbëjë numrin e nevojshëm për zhvillimin e një mbledhje për realizimin e çdo veprimtarie.

Neni 10

Kuorumi në Mbledhjet e Posaçme

Mbledhjet e posaçme të drejtorëve për çfarëdo lloj arsyeje, në rast se nuk është parashikuar ndryshe nga Statuti ose Akti i Themelimit, mund të thirren nga Drejtori Ekzekutiv me iniciativën e tij ose nga Drejtori Ekzekutiv ose sekretari në bazë të kërkesës me shkrim të shumicës së drejtorëve me të drejtë vote. Një kërkesë e tillë duhet të deklarojë dhe qëllimin e mbledhjes së propozuar.

Neni 11
Njoftimi për Mbledhjen

Njoftimi me shkrim që deklaron vendin, datën dhe kohën e mbledhjes si dhe natyrën e përgjithshme të çështjes në shqyrtim, do t'i dërgohet çdo drejtori me të drejtë vote në adresën e tij siç është shkruar në regjistrat e Fondacionit, jo më pak se njëzet dhe jo më shumë se pesëdhjetë ditë para datës së mbledhjes.

Neni 12
Diskutimi i çështjeve të papërfshira në njoftim

Asnjë çështje apo veprim, që nuk është përfshirë në njoftimin e mbledhjes, nuk mund të diskutohet apo kryhet në mbledhje pa marrë me pare konsensusin unanim të të gjithë drejtorëve.

Neni 13
Dhënia e pëlqimit me shkrim

Për çdo veprim ose mosveprim për të cilin kërkohet mbledhje e Bordit të Drejtorëve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga Akti i Themelimit dhe Statuti, mbledhja dhe vota e drejtorëve mund të mos jenë të domosdoshme nëse të gjithë drejtorët që kanë të drejtë vote mbi këtë veprim nëse mbledhja do të mbahej, do të jenë dakord me shkrim që Fondacioni ta kryejë këtë veprim apo mosveprim

DREJTORËT E BORDIT TË DREJTORËVE

Neni 14
Numri i drejtorëve të Bordit të Drejtorëve dhe emërimi i tyre

Numri i drejtorëve do të jetë 11, ku 10 drejtorë do të jenë të emëruar sipas rregullit të vënë nga Akti i Themelimit dhe 1 do të zgjidhet nga të emëruarit, sipas Statutit, ose jo më pak seç e parashikon ligji.

Drejtorët e emëruar do të emërohen 30 ditë para mbledhjes vjetore dhe brenda 30 ditëve në rastin e mbetjes së një vendi bosh nëse ky vend mbetet bosh ndërmjet mbledhjeve vjetore dhe çdo drejtor do të emërohet ose zgjidhet për të shërbyer derisa pasuesi i tij emërohet ose zgjidhet dhe do të kualifikohet.

Neni 15
Rastet e dorëheqjeve

Secili prej drejtorëve, anëtarëve të komiteteve, ose zyrtarëve të tjerë mund të japë dorëheqjen në çdo kohë. Dorëheqje të tilla do të bëhen me shkrim dhe do të bëhen efektive në një kohë të caktuar, dhe nëse koha nuk është caktuar, do të bëhen efektive me marrjen e tyre nga ana e Drejtorit Ekzekutiv ose sekretarit. Drejtorët e emëruar duhet t'i japin njoftimin e dorëheqjes entitetit që i ka emëruar në të njëjtën kohë që njoftimi u jepet zyrtarëve të fondacionit. Pranimi i dorëheqjes nuk do të jetë i nevojshëm për ta bërë atë efektive.

Neni 16
Plotësimi i vendeve bosh

Nëse posti i çdonjërit prej drejtorëve, anëtarëve të një komiteti ose zyrtarëve të tjerë mbetet bosh dhe nëse entiteti që bën emërimin siç specifikohet në Aktin e Themelimit, refuzon të bëjë emërimin ose në rast të mosveprimit brenda 30 ditëve, drejtorët e mbetur në postet e tyre, megjithëse numri aktual nuk përbën kuorum, mund të emërojnë çdonjërin prej personave të kualifikuar për mbushjen e vendit bosh, dhe mbajtjen e postit deri në fund të afatit dhe derisa pasuesi i tij të zgjidhet në mënyrën e duhur.

Neni 17

Heqja nga detyra e Drejtorit të Bordit të Drejtorëve

Çdo drejtor ose disa drejtorë mund të largohen me ose pa shkak, në çfarëdo kohe me 2/3 e votave të të gjithë drejtorëve të Bordit të Drejtorëve me të drejtë vote në një mbledhje të posaçme të drejtorëve të thirrur për këtë qëllim, dhe vendi i mbetur bosh mund të mbushet në mbledhjen e mbajtur me qëllim largimin, sipas kushteve të këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit.

Neni 18

Rritja e numrit të Drejtorëve

Numri i drejtorëve mund të rritet me ndryshim të këtij Statuti dhe me votën e 2/3 të drejtorëve të Bordit të Drejtorëve.

Neni 19

Shpërblimi i Drejtorëve

Drejtorët nuk mund të marrin pagë për shërbimet e tyre si drejtorë ose anëtarë të komitetit, por me vendim të Bordit mund të jepet një shumë fikse dhe shpenzimet për marrjen pjesë në çdo takim. Asgjë e përfshirë këtu nuk mund të ndalojë çdonjërin prej drejtorëve t'i shërbejë korporatës në çdo funksion tjetër si zyrtar, agjent ose gjë tjetër, dhe për këtë të marrë shpërblim.

Neni 20

Dhënia e pëlqimit me shkrim

Çdo veprim ose mosveprim për të cilin kërkohet mbledhje e Bordit të Drejtorëve ose të çdonjërit prej komiteteve të tij, mund të ndërmerret pa u bërë mbledhja nëse të gjithë drejtorët që kanë të drejtë vote mbi këtë veprim nëse mbledhja do të mbahej, do të jenë dakord me shkrim që Fondacioni ta kryejë këtë veprim apo mosveprim dhe ky aprovim i nënshkruar është regjistruar në proces-verbalin e Bordit ose të komitetit.

ZYRTARËT

Neni 21

Zyrtarët e Fondacionit

Zyrtarët e korporatës do të përbëhen nga një Drejtor Ekzekutiv, një mbajtës thesari (Arkëtari) dhe një sekretar dhe do të zgjidhen nga Bordi i Drejtorëve, dhe do të mbajnë postet e tyre derisa të jenë zgjedhur pasuesit e tyre.

Përveç kësaj Bordi i Drejtorëve mund të zgjedhë një kryetar të tij, një ose disa zv/Drejtor Ekzekutivë dhe asistent sekretar e asistent mbajtës thesari nëse duket e arsyeshme. Asnjë prej zyrtarëve të Fondacionit, përveç Kryetarit të Bordit nuk është e nevojshme të jenë drejtorë. Zyrtarët do të zgjidhen në mbledhjen e parë të Bordit të Drejtorëve pas çdo mbledhje vjetore. Një person mund të mbajë më shumë se dy poste, përveç posteve të Drejtorit Ekzekutiv e sekretarit. Asnjë zyrtar nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës në Bordin e Drejtorëve përveç kryetarit i cili duhet të jetë anëtar i Bordit të Drejtorëve.

Bordi i Drejtorëve mund të emërojë një ose disa drejtorë shkolle me pagë për menaxhimin e programeve arsimore të Shkollës Teknike Harry T.Fultz si ta shikojë të arsyeshme. Ky (këta) drejtor shkolle do të ketë përgjegjësinë të raportojë para Bordit të Drejtorëve sipas kërkesave, lidhur me aktivitetin e kaluar dhe strategjitë e planet operacionale.

Neni 22

Zyrtarë të tjerë të Fondacionit

Bordi i Drejtorëve mund të emërojë zyrtarë dhe agjentë të tillë, siç mund të shihet e arësyeshme, të cilët do të mbajnë postet e tyre për afate të caktuara, do të ketë kompetenca të caktuara dhe do të kryejnë detyra të tilla që do të përcaktohen kohë pas kohe nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 23

Kryetari i Bordit të Drejtorëve

Kryetari i Bordit të Drejtorëve, nëse një i tillë zgjidhet, do të drejtojë të gjitha mbledhjet e Bordit të Drejtorëve, dhe ai ose ajo duhet të kryejë detyra të tilla që do t'i ngarkohen kohë pas kohe nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 24

Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit

Drejtori Ekzekutiv do të jetë zyrtari ekzekutiv kryesor i Fondacionit dhe do të ketë fuqitë e përgjithshme dhe detyrat e mbikqyrjes e menaxhimit që zakonisht i vishen postit të Drejtorit Ekzekutiv të një shoqërie tregtare. Ai ose ajo do të drejtojë të gjitha mbledhjet e drejtorëve nëse është prezent, në mungesë ose në rastin kur nuk është zgjedhur një kryetar i Bordit të Drejtorëve, dhe do të ketë mbikqyrjen, drejtimin dhe kontrollin e përgjithshëm të çështjeve të Fondacionit.

Përveç rastet kur Bordi i Drejtorëve do të autorizojë ekzekutimin e tyre në ndonjë mënyrë të veçantë, ai ose ajo do të ekzekutojë detyrimet, hipotekat dhe kontratat e tjera në emër të Fondacionit dhe do të bashkangjisë vulën të çdo instrument që e kërkon atë dhe vula do të vërtetohet nga firma e sekretarit ose mbajtësit të thesarit ose asistentit të sekretarit ose asistentit të mbajtësit të thesarit.

Neni 25

Zv/Drejtori Ekzekutiv

Çdo zv/Drejtor Ekzekutiv do të ketë fuqi të tilla dhe do të realizojë detyra të tilla që do i ngarkohen nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 26

Mbajtësi i thesarit (Arkëtari)

Mbajtësi i thesarit do të ketë nën kujdes fondet dhe siguracionet dhe do të mbajë një llogari të plotë dhe të saktë në libra, të faturave dhe pagesave që i përkasin Fondacionit. Ai do të depozitojë të gjitha paratë dhe sendet me vlerë në emrin dhe për kredi të Fondacionit në depozita të tilla që mund të jenë caktuar nga Bordi i Drejtorëve.

Mbajtësi i thesarit do të disbursojë fondet e Fondacionit siç mund të jetë udhëruar nga Bordi i Drejtorëve ose Drejtori Ekzekutiv, duke marrë faturat përkatëse për disbursime të tilla. Ai ose ajo do t'i japë Drejtorit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve në mbledhjet e rregullta të Bordit të Drejtorëve ose në rastet kur mund të kërkohet, një llogari të të gjitha veprimeve të tij ose të saj si mbajtës i thesarit si dhe të informoje mbi situatën financiare të Fondacionit.

Neni 27

Sekretari

Sekretari do të japë ose do të mundësojë dhënien e njoftimit për të gjitha mbledhjet e drejtorëve, dhe të gjitha njoftimeve të tjera që kërkon ky ligj ose ky Statut dhe në rastin e mungesës së tij ose refuzimit e neglizhencës për të vepruar, çdo njoftim i tillë mund të jepet nga çdo person i drejtuar nga Drejtori Ekzekutiv, ose nga drejtorët nën kërkesën e të cilëve mbledhja thirret siç parashikohet në këtë Statut.

Ai ose ajo do të mbajë proces-verbalin e të gjitha mbledhjeve të Fondacionit dhe të drejtorëve në një libër që do të mbahet për këtë qëllim, dhe do t'i bashkangjisë vulën të gjitha dokumentave (instrumentave) që e kërkojnë, kur autorizohet nga drejtorët ose Drejtori Ekzekutiv, dhe ta vërtetojë atë.

Neni 28

Asistentë të mbajtësit të thesarit dhe asistentë të sekretarit

Asistenti i mbajtësit të thesarit dhe asistenti i sekretarit, nëse ndonjë i tillë do të zgjidhet, do të kenë fuqi të tilla dhe do të kryejnë detyra të tilla që do t'u ngarkohen, respektivisht nga drejtorët.

MOSLEJIMI I DIVIDENDËVE

Neni 29

Moslejimi i dividendëve

Asnjë pjesë e të ardhurave neto të Fondacionit nuk mund të shkojë në përfitim të ose të jetë e ndashme në formën e dividendit midis, drejtorëve, zyrtarëve ose personave të tjerë privatë, përveç rastit kur Fondacioni do të autorizohet e fuqizohet për pagimin e një shpërblimi të arësyeshëm për shërbimet e përfituara dhe për bërjen e pagesave dhe shpërndarjeve për avancimin e qëllimeve të renditura në Aktin e Themelimit.

Në rast të shpërndarjes së Fondacionit, Bordi i Drejtorëve pas pagimit ose plotësimit të kushteve për pagimin e të gjitha detyrimeve të Fondacionit, do t'i japë fund të gjitha mjeteve të Fondacionit ekskluzivisht për qëllimin e krijimit të Fondacionit në mënyrë të tillë, ose do t'ia kalojë ato një organizate ose organizatave të tilla të organizuara dhe që veprojnë ekskluzivisht për qëllime bamirësie, arsimit ose shkence, sipas metodës së deklaruar në Aktin e Themelimit.

VULA E FONDACIONIT

Neni 30

Vula e Fondacionit

Vula e Fondacionit do të jetë rrumbullake në formë dhe do të përmbajë emrin e Fondacionit, vitin e krijimit të tij dhe fjalët "VULA E FONDACIONIT SHQIPTARO-AMERIKAN TË ARSIMIT TEKNIK HARRY T. FULTZ". Vula e përmendur mund të përdoret nëpërmjet stampimit, ose bashkëngjitjes ose ndonjë mënyrë tjetër riprodhimi, të saj ose një faksimile të saj.

VITI FISKAL

Neni 31

Viti Fiskal

Viti fiskal i Fondacionit do të përcaktohet me vendim të Bordit të Drejtorëve.

DOKUMENTAT FINANCIARE TË FONDACIONIT

Neni 32

Ekzekutimi i dokumentave financiare të Fondacionit

Të gjitha çeqet, urdhëresat për pagimin e parave, evidencat e detyrimeve të nxjerra nën emrin e Fondacionit, si dhe çdo instrument tjetër financiar, do të firmosen nga zyrtarët, agjenti ose agjentët e Fondacionit dhe në mënyrë të tillë që do të përcaktohet kohë pas kohe me vendim të Bordit të Drejtorëve.

NJOFTIMI DHE HEQJA DORË NGA NJOFTIMI

Neni 33 Njoftimi

Një njoftim i kërkuar nga Statuti, quhet i dhënë vetëm atëherë kur ai (njoftimi) është dhënë shprehimisht. Çdo njoftim i këtij lloji do të quhet i mjaftueshëm nëse jepet me fax dhe postë elektronike, adresuar ndaj personit që e ka këtë të drejtë, në numrin e tij ose të saj të fax-it ose në adresën e tij ose të saj të postës elektronike siç paraqitet në regjistrat e Fondacionit dhe një njoftim i tillë do të konsiderohet i dhënë në ditën që kryhet një veprim i tillë.

Neni 34 Heqja dorë nga njoftimi

Sa herë që një njoftim i çfarëdoshëm kërkohet të jepet bazuar në ligj, në Aktin e Themelimit ose në Statut, një dokument i shkruar për heqje dorë nga marrja e njoftimit, i firmosur nga personi ose personat që kanë të drejtën e një njoftimi të tillë, para ose pas kohës së deklaruar në të, do të konsiderohet si njoftim i mjaftueshëm.

NDRYSHIMET NË STATUT

Neni 35 Ndryshimet në Statut

Ky Statut mund të ndryshohet dhe të anulohet dhe Statute mund të përpilohen në çdo mbledhje vjetore të drejtorëve ose mbledhje të posaçme të tyre, nëse njoftimi për të është i përfshirë në njoftimin për një mbledhje të posaçme të tillë, nga aprovimi në çdo mbledhje të rregullt të Bordit të Drejtorëve ose në ndonjë mbledhje të posaçme të Bordit të Drejtorëve nëse njoftimi për këtë përmbahet në njoftimin e një mbledhje të posaçme të tillë.

V E N D I M Nr.255, datë 27.5.2000

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE, PËR PRIVATIZIMIN E “ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS (AMC), SH.A.”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 6, të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999, “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Albanian Mobile Communication (AMC)””, të vendimeve nr.329, datë 12.7.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti me shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, nr.581, datë 8.12.1999, “Për kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e shoqërisë anonime “AMC” dhe nr.199, datë 29.4.2000, “Për miratimin e projektkontratës për blerjen e aksioneve dhe të instruksioneve për paraqitjen dhe hapjen e ofertave për privatizimin e “Albanian Mobile Communications” (AMC) sh.a.”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave, për privatizimin e “Albanian Mobile Communications” (AMC), sh.a.”, të miratuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave.
2. Në mbështetje të raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave, për privatizimin e AMC-së,

sh.a. dhe të tabelës së kriterëve të vlerësimit të ofertave për privatizimin e AMC, sh.a., ofertat klasifikohen si vijon:

- | | |
|---------------------------|----------|
| • Telenor/Cosmote | 990 pikë |
| • Albatel/Panafon/Vodafon | 546 pikë |
| • Turkcell | 497 pikë |

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në mbështetje të klasifikimit (pika 2), të fillojë negociimet dhe nënshkrimin e marrëveshjes me të klasifikuarin e parë Cosmote/Telenor, në përputhje me nenet 7.3 dhe 7.4, të “Instruksioneve për paraqitjen dhe për hapjen e ofertave në privatizimin e AMC, sh.a.”, e miratuar me vendimin nr.199, datë 29.4.2000, të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.261, datë 25.5.2000

PËR NË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.317, DATË 8.7.1999, “PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat dhe caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në paragrafin e tretë të pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.317, datë 8.7.1999, “Për shpërblimin e punës së punonjësve”, pas fjalisë: “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme deri në 1:7”, shtohet shprehja: “por jo më shumë se paga e klasifikimit A8”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.262, datë 25.5.2000

PËR DHËNIEN E LEJES PËR PUNË SHTETASVE TË HUAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 83 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999, “Për të huajt”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale është institucioni i cili kujdeset për përpunimin e politikave të punësimit të shtetasve të huaj koordinon veprimtarinë e strukturave të punësimit të shtetasve të huaj, dhe pajis shtetasit e huaj me leje për në Republikën e Shqipërisë.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe strukutrat e saj bashkëpunojnë me institucionet e tjera për përcaktimin e drejtimeve të zhvillimit të tregut të punës së të huajve në Republikën e Shqipërisë.

2. Zyra e punësimit, sektori i migracionit, në njësinë vendore pajis me:

Leje pune të tipit B, leje pune të tipit D, në të gjitha rastet kur veprimtaria e lejekërkuesit shtrihet vetëm në një njësi vendore.

3. Drejtoria e Migracionit, në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, pajis me:

a) Leje pune të tipit A, leje pune të tipit B, leje pune të tipit D, kur veprimtaria e lejekërkuesit shtrihet në më tepër se një njësi vendore;

b) Leje pune të tipit C, leje pune të tipit E, leje pune të tipit F, leje pune të tipit G, leje pune të tipit H, që nuk kanë kufizime gjeografike;

c) Lejet e punës pa kufizime, për personat që parashikon neni 33 i ligjit;

ç) Lejet e punës për personat që zhvillojnë aktivitetin e tyre në njësitë vendore ku mungon zyra e punësimit.

4. Shtetasi i huaj që aplikon për leje pune të tipit A, leje pune të tipit B, leje pune të tipit D, leje pune të tipit E, leje pune të tipit F, leje pune të tipit G, paraqet pranë organit kompetent dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën me një historik të shkurtër të punësimit të tij.

b) Kopjen e firmosur të kontratës së punës të nënshkruar midis palëve.

c) Kualifikimet, në përshtatje me kontratën dhe vendin e punës.

ç) Kërkesën me shkrim të punëdhënësit që do të bëjë punësimin dhe dokumentin, për punësimin e dy shqiptarëve kundrejt një shtetasi të huaj.

d) Vendimin e gjykatës së vendit të origjinës, ku është regjistruar si person juridik.

dh) Proven e hyrjes së ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

e) Dokumentin që tregon pjesëmarrjen në skemën e sigurimeve shoqërore ose dëshmi për sigurim shoqëror në vendin e origjinës.

ë) Raportin mjeko-ligjor lëshuar nga autoritetet kompetente në vendin e origjinës ose në Republikën e Shqipërisë.

f) 4 fotografi.

g) Formularin tip që jepet në organin që lëshon lejen e punës.

Në rast të ripërtëritjes së lejeve të tipeve të mësipërme, nga lejekërkuesit duhet të dokumentohet shlyerja e detyrimeve në Zyrën e Tatimeve, akt-kontrolli i ISHP-së si dhe leje paraardhëse e punës.

5. Shtetasi i huaj që aplikon për leje pune të tipeve C dhe H, paraqet pranë organit kompetent dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën me një historik të shkurtër të punësimit të tij.

b) Kopjen e firmosur të kontratës së punës të nënshkruar midis palëve.

c) Kualifikimet, në përshtatje me kontratën dhe vendin e punës.

ç) Kërkesën me shkrim të punëdhënësit që do të bëjë punësimin dhe dokumentim të zbatimit të ligjit, për punësimin e dy shqiptarëve kundrejt një shtetasi të huaj.

d) Vendimin e gjykatës si person juridik.

dh) Proven e hyrjes së ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

e) Dokumentin që tregon pjesëmarrjen në skemën e sigurimeve shoqërore ose dëshmi për sigurim shoqëror në vendin e origjinës.

ë) Raportin mjeko-ligjor lëshuar nga autoritetet kompetente në vendin e origjinës ose në Republikën e Shqipërisë.

f) 4 fotografi.

g) Formularin tip, që jepet në organin që lëshon lejen e punës.

gj) Dokumentimin e shlyerjes së detyrimeve të punëdhënësit që bën punësimin, konfirmën nga ISHP-ja, nga zyra e tatim-taksave si dhe lejen paraardhëse të punës.

Të gjitha dokumentet e kërkuara nga vendi i origjinës, sipas paragrafeve 4 dhe 5, duhet të jenë të noterizuara.

6. Shtetasit e huaj, aplikant për leje pune, i refuzohet kërkesa në rast se ai nuk arrin të plotësojë qoftë edhe një nga kriteret e përshkruara nga neni 4 deri në nenin 11 të ligjit. Gjithashtu leja e punës mund të refuzohet kur konstatohen shkelje të ligjeve në fuqi nga ana e punëdhënësit,

punëmarrësit apo personave të vetëpunësuar.

7. Leja e punës anulohet kur ndryshojnë kushtet thelbësore të miratimit të saj dhe në rastet kur kontrata e punës bëhet e pavlefshme, sipas dispozitave të Kodit të Punës.

8. Shtetasi i huaj, leja e punës e të cilit është anuluar, ka të drejtë të ankohet brenda dy javësh, një instancë më lart, për vendimin e anulimit.

Në rast të një përgjigjeje negative, i huaji ka të drejtë të ankohet tek titullari një javë pas marrjes së përgjigjes për ankesën.

Përgjigja në shkallën e dytë është përfundimtare dhe jepet brenda një jave nga data e bërjes së ankimit.

9. Drejtoria e Migracionit grumbullon informacionin për të gjitha aplikimet e shqyrtuara nga zyra e punësimit të njërive vendore, ndërton bazën e të dhënave dhe bën përpunimin statistikor.

Drejtoria e Migracionit bën raportin vjetor për vlerësimin e situatës së punësimit të të huajve, me sugjerimet përkatëse për politikën shtetërore në këtë fushë.

10. Tarifat për lejet e punës janë nga 2 000 lekë deri në 10 000 lekë. Masa e tyre për çdo tip leje pune përcaktohet me udhëzim të veçantë të ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.

11. Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale përcakton me udhëzime të veçanta:

a) Mënyrën e koordinimit dhe veprimtarinë e institucioneve në linjë vertikale.

b) Formularin tip që plotësohet nga lejekërkuarët sipas kategorive.

c) Modelin e lejes së punës, sipas kategorive të shprehura në ligj.

ç) Afatet kohore të lejes së punës.

12. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimet e nevojshme në mbështetje dhe në zbatim të këtij vendimi.

13. Vendimi nr.680, datë 30.10.1995, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e lejes për punë shtetasve të huaj” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M

Nr.263, datë 25.5.2000

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT, E MIRATUAR ME VENDIMIN NR.42, DATË 17.1.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në statutin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

NË STATUTIN E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT BËHEN NDRYSHIMET E
MËPOSHTME:

1. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas bëhet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

2. Në fund të nenit 1 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Këshilli i Ministrave miraton simbolin e SHKP”.

3. Neni 7 ndryshohet si vijon:

“Buxheti i investimeve vjetore të SHKP bëhet vetëm me aprovim të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe në asnjë rast nuk kalon 10 për qind të buxhetit vjetor të shpenzimeve të SHKP.

4. Neni 24 bëhet paragrafi 2 i nenit 8.

5. Në fund të nenit 10 shtohet togfjalëshi “nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale”.

6. Në nenin 11 hiqet fjala e fundit.

7. Në nenin 12 fjala “një vit” zëvendësohet me fjalën “2 vite”. Fjala “emërtim” bëhet “emërim”.

Mbas fjalës “kalendarik” shtohet fjalitë: “Miratimi i emërimit të anëtarëve bëhet nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale. Përfaqësitë e institucioneve shtetërore duhet të jenë në nivel zëvendësministër ose drejtor drejtorie”. Në fund shtohet fjalia “Këshilli ushtron veprimtarinë sipas rregullores së funksionimit të tij”.

8. Në nenin 13 fjala “gjashtë” bëhet “katër”, pas fjalës “sociale” shtohet togfjalëshi “në raste të veçanta” dhe togfjalëshi “tre të katërtat” zëvendësohen me fjalën “gjysma”.

9. Në pikën 5 të nenit 14 shtohet në fund “më të rëndësishme të SHKP sipas rregullores përkatëse. Pika 6 ndryshohet si vijon “miraton strukturat e përgjithshme të SHKP dhe rregulloret e SHKP”.

Shtohet pika 7 me këtë përmbajtje: “krijon Komisionin e Kontrollit për kontrollin e veprimtarisë së tij.

10. Në nenin 15 pas fjalisë së parë pjesa tjetër e nenit ndryshohet si vijon:

“Ai emërohet nga Kryeministri me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe përgjigjet para këtij të fundit për veprimtarinë e tij.

Drejtori i Përgjithshëm shkarkohet kur:

a) Jep dorëheqjen;

b) Gjatë ushtrimit të detyrës dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë;

c) Kur është në pamundësi fizike a mendore për të kryer funksionet e ngarkuara;

d) Konkludohet paaftësia, me dy vlerësime negative të njëpasnjëshme të punës.

11. Në nenin 16 pika 4 ndryshohet si vijon:

“Me miratim të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale emëron drejtorët e drejtorive në SHKP, ata të nivelit lokal si dhe drejtorët e institucioneve të tjera në vartësi të SHKP”

Në këtë nen shtohen katër pikat e mëposhtme:

- emëron personel të niveleve të tjera të SHKP

- propozon në Këshill strukturat e përgjithshme të SHKP

- propozon në Këshill buxhetin vjetor, bilancin vjetor dhe detajimin e buxhetit

- propozon dhe sipas rastit miraton programet kualifikuese për stafin në nivel qendror dhe lokal

12. Në nenin 18 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Këshilli lokal trepalësh përbëhet nga përfaqësues të zyrës së punësimit, organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve. Të drejtat, detyrat dhe përbërja e këshillit lokal trepalësh përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale”.

13. Në nenin 21 në fjalinë e parë hiqet togfjalëshi “informacion për:”

Shtohet pika e fundit me këtë përmbajtje: “(IV) veprimtarinë e saj, realizimin e buxhetit, realizimin e programeve të punës, informacionin statistikor për nivelin qendror dhe lokal”.

14. Titulli “Dispozita të përgjithshme dhe kalimtare” hiqet.

15. Neni 22 ndryshohet si vijon: “SHKP paraqet në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale propozimet për projektbuxhetin, ndryshimet në legjislacion, çdo iniciativë për projekte, studime dhe bashkëpunime të reja si dhe për papunësinë dhe tregun e punës”.

16. Në nenin 23 shtohet paragrafi i parë me këtë përmbajtje:

“SHKP bashkëpunon me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Shërbimin Social Shtetëror dhe Inspektoriatin Shtetëror të Punës për bashkërendimin e koordinimin e aktiviteteve.”

Paragrafi i parë bëhet i dytë i këtij neni.

17. Neni 24 bëhet: “Shërbimi Kombëtar i Punësimit kontrollon institucionet publike dhe private për aktivitetin e tyre dhe i propozon Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale autorizimin e tyre”.

V E N D I M
Nr. 266, datë 25.5.2000

**PËR NDRYSHIMIN E EMRIT ZYRTAR TË INSTITUTIT TË LARTË TË KULTURËS
FIZIKE “VOJO KUSHI” NË AKADEMIA E EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTEVE “VOJO
KUSHI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Emri i Institutit të Lartë të Kulturës Fizike “Vojo Kushi” ndryshohet në Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”.
 2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për Institutin e Lartë të Kulturës Fizike “Vojo Kushi”.
 3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.269, datë 25.5.2000

**PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT, MAGAZINIMIT, PRODHIMIT E TË TRANSFERIMIT
TË MINAVE KUNDËR PERSONIT DHE SHKATËRRIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të neneve 100 dhe 122, të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8547, datë 11.11.1999, “Për ratifikimin e Konventës “Për ndalimin e përdorimit, magazinimit, prodhimit e të transferimit të minave kundër personit dhe shkatërrimin e tyre”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në Republikën e Shqipërisë ndalohet përdorimi i të gjitha llojeve të minave kundër personit (MKP).
2. Në Republikën e Shqipërisë ndalohet prodhimi i të gjitha tipeve të minave kundër personit nga subjektet shtetërore dhe private.
3. Ndalohet shitja dhe eksportimi i minave kundër personit.
4. Ministria e Mbrojtjes të heqë nga kompletimi i Forcave të Armatosura të gjitha tipet e minave kundër personit, që ka sot në përdorim.
5. Të asgjësohen të gjitha minat kundër personit, që janë në inventar të Forcave të Armatosura, brenda vitit 2004.

6. Lejohet transferimi i minave kundër personit vetëm për efekt të grumbullimit, me qëllim asgjësimi, sipas programit të miratuar.

7. Të përcaktohen dhe të pastrohen të gjitha sipërfaqet e infektuara me mina në territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda vitit 2009.

8. Ministria e Mbrojtjes në mbështetje të pikave 5 dhe 7 të këtij vendimi, të paraqesë në Këshillin e Ministrave, programin dhe efektet financiare të nevojshme për realizimin e këtyre detyrimeve, tre muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

9. Ministria e Punëve të Jashtme dhe institucionet e tjera shtetërore, nëpërmjet kontakteve zyrtare me qeveritë e shteteve palë ose jo në konventë, me Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe organizatat joqeveritare të kërkojë, mbështetje financiare dhe teknologjike për realizimin e projekteve të asgjësimit të minave kundër personit, pastrimin e fushave të minuara, si dhe ndihmë për viktimat e minave.

10. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Jashtme, të bashkëpunojnë ndërmjet tyre në drejtimin e informimit të ndërsjellë, për zbatimin e programit, dhe kjo e fundit të raportojë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm, jo më vonë se 30 prilli i çdo viti, për punën që bëhet dhe për problemet që dalin në procesin e zbatimit të programit, sipas përcaktimeve të konventës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 440, datë 1.6.2000

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË RADIOTELEVIZIONIT
SHQIPTAR (RTSH)

Në mbështetje të nenit 143 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit Drejtues të RTSH-së,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
OBJEKTI DHE DEKLARATA E QËLLIMIT

Neni 1

Objekti

1. Statuti i Radiotelevizionit Shqiptar, i hartuar në bazë dhe në detyrim të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", ka për objekt rregullimin e përgjithshëm dhe në hollësi të veprimtarisë së këtij institucioni kombëtar.

2. Ky Statut synon të caktojë rregulla të mjaftueshme, që mundësojnë procesin e kalimit nga radiotelevizion shtetëror në radiotelevizion publik dhe të garantojë funksionimin normal të RTSH-së.

Neni 2

Deklarata e qëllimit

1. Si një transmetues i përkushtuar ndaj idealeve më të larta të transmetimit të shërbimit publik

kombëtar, RTSH-ja realizon shërbime cilësore radioje dhe televizioni për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë edhe pakicat kombëtare.

2. RTSH-ja zotohet për një mbulim të paanshëm të lajmeve të vendit dhe ndërkombëtare.

3. RTSH-ja realizon programe, të cilat duhet të pasqyrojnë larminë e jetës shqiptare të dëgjuesit dhe shikuesit të gjitha moshave. RTSH-ja përgatit programe cilësore e me vlera për pasurimin e botës mendore dhe shpirtërore të njerëzve.

KREU II EMËRTIMI DHE PËRFAQËSIMI JURIDIK

Neni 3

1. Radiotelevizioni Publik Shqiptar emërtohet: "Radiotelevizioni Shqiptar". Emri i shkurtuar i institucionit është RTSH.

2. Emri i Televizionit Publik Shqiptar është "Televizioni Shqiptar" (shkurt TVSH).

3. Emri i Radios Publike Shqiptare është "Radio Tirana" (shkurt RT).

4. Qendrat rajonale të radios e televizionit janë:

- Radio Shkodra (shkurt RSh)
- Radio Kukësi (shkurt RKu)
- Radio Gjirokastra (shkurt RGj)
- Radio Korça (shkurt RKo).

5. Drejtoria e Stacioneve Transmetuese të RTV-së përbëhet nga:

- Stacioni i RTV-së, Elbasan
- Stacioni i RTV-së, Tiranë
- Stacioni i RTV-së, Durrës

6. RTSH-ja është person juridik, i krijuar si i tillë me ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë".

7. Selia e RTSH-së është në Tiranë.

8. TVSH-ja, RT-ja, radiot vendore dhe Drejtoria e Stacioneve Transmetuese të RTV-së, janë njësi administrative struktura në përbërje të RTSH-së dhe, njëkohësisht, janë persona juridikë me zotësi juridike të kufizuar, sipas përcaktimeve ligjore në këtë statut. Përveç qendrave rajonale të radios dhe televizionit, të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, me vendim të Këshillit Drejtues të RTSH-së, mund të krijohen edhe njësi të tjera analoge.

9. Vula zyrtare e RTSH-së është në formë rrethore dhe përmban këto shënja e shkronja në rrethin e jashtëm: Lart: "Republika e Shqipërisë", poshtë TIRANË dhe në rrethin e brendshëm lart: "Radiotelevizioni Shqiptar", ndërsa në mes të saj vihet shqiponja, e njëjtë me atë të stemës së Republikës.

10. Madhësia dhe përmasat e vulave të tjera caktohen me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues.

Neni 4

1. RTSH-ja funksionon si një sistem unik me njësi të tjera administrative përbërëse.

2. Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, si menaxher kryesor i këtij sistemi, përfaqëson RTSH-në dhe vepron në emër të këtij institucioni në të gjitha marrëdhëniet juridike me persona të tretë, në të gjitha transaksionet ku palë është RTSH-ja, përveç atyre të pasurive të paluajtshme.

3. Në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm, Radiotelevizioni Shqiptar përfaqësohet nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm dhe, në mungesë të tij, nga njëri prej drejtuesve të RT-së ose të TSHV-së, i cili autorizohet me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm.

4. Autorizimet e përfaqësimit për më shumë se 60 ditë duhet të miratohen nga Këshilli Drejtues.

5. Institucionet përbërëse të RTSH-së, TVSH-ja, RT-ja, Drejtoria e Aktualitetit, Drejtoria e Stacioneve Transmetuese të RTV-së, si dhe radiot vendore përfaqësohen nga drejtorët përkatës në të gjitha marrëdhëniet juridike me persona të tretë, ku palë janë institucionet përkatëse, brenda të drejtave

dhe detyrimeve ligjore që ata kanë. Në rastet kur vërehen parregullsi ose shkelje të kompetencave, Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të ndërhyjë, për t'i bërë të pavlefshme vendimet ose marrëveshjet e arritura.

KREU III STRUKTURA E RTSH-SË, ORGANET E SAJ DREJTUESE DHE MËNYRA E ZGJEDHJES SË TYRE

Neni 5

RTSH-ja e kryen veprimtarinë e vet mbështetur në:

- a) drejtimin ekonomiko-financiar të decentralizuar;
- b) prodhimin e programeve radiotelevizive për transmetim në RTSH dhe për të tretët;
- c) transmetimin radioteleviziv për programin e RTSH-së dhe për të tretët.

Neni 6

RTSH ka këtë strukturë organizative:

- a) Drejtoria e Përgjithshme të RTSH-së.
- b) Drejtoria e Televizionit Shqiptar.
- c) Drejtoria e Radio Tiranës.
- ç) Drejtoria e Stacioneve Transmetuese të RTV-së.
- d) Qendrat rajonale të radios e televizionit.
- dh) Drejtoria Ekonomiko- financiare.
- e) Drejtoria e Aktualitetit.

Neni 7

1. Strukturat e njësive administrative përbërëse të RTSH-së propozohen nga drejtoritë përkatëse të RTSH-së, miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm dhe marrin fuqi pasi të jenë miratuar nga Këshilli Drejtues. Kur mendimi i Drejtorit të Përgjithshëm është i ndryshëm nga propozimi i njësive administrative, Këshilli Drejtues i paraqiten të dyja variantet.

2. Ndryshimet në strukturat e njësive administrative bëhen mbi propozime të argumentuara dhe ndjekin të njëjtin rregull.

Neni 8

1. Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", organet drejtuese të RTSH-së janë:

- a) Këshilli Drejtues.
- b) Drejtori i Përgjithshëm.
- c) Bordi i Administrimit.

2. Për organizimin e përditshëm të punës veprojnë edhe organet drejtuese të njësive administrative dhe strukturat e tjera vartëse, si më poshtë:

- a) Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm;
- b) Drejtori i Televizionit Shqiptar;
- c) Drejtori i Radio Tiranës;
- ç) Drejtori i Drejtorisë së Aktualitetit;
- d) drejtor drejtorie pranë Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së;
- dh) Zëvendësdrejtori i Televizionit Shqiptar;
- e) Zëvendësdrejtori i Radio Tiranës;
- ë) drejtor departamenti në Radio Tirana e në Televizionin Shqiptar;
- f) drejtor teknik në Radio e në Televizion (kryeinxhinieri);
- g) drejtorët e radiove vendore;
- gj) Drejtori i Drejtorisë së Stacioneve Transmetuese të RTV-së.

KRITERET DHE PROCEDURAT E ZGJEDHJES

Neni 9

Përzgjedhja e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së

Kriteret e përzgjedhjes së anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së janë të përcaktuara në nenet 88, 89 dhe 90 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 10

Kriteret e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së

1. Këshilli Drejtues i RTSH-së shpall publikisht kriteret e konkurrimit për Drejtor të Përgjithshëm të RTSH-së, të cilat janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë kryer arsimin e lartë;
- c) të jetë intelektual, me veprimtari krijuese publike;
- ç) të ketë përvojë punë në media ose në administrimin publik jo më pak se pesë vjet;
- d) të ketë aftësi drejtuese e menaxhuese dhe ide të qarta për zhvillimin e një radiotelevizioni publik.

2. Kandidatët duhet të paraqesin në Këshillin Drejtues, sipas kërkesave që përcakton ligji, curriculum vitae të plotë, platformën dhe idetë e tyre për Radiotelevizionin Publik Shqiptar, strukturën programore dhe organizative të sistemit të RTSH-së, planin e menaxhimit për veprimtarinë prodhuese e financiare të këtij institucioni.

3. Drejtori i Përgjithshëm nuk lejohet të jetë në të njëjtën kohë deputet, anëtar i Këshillit të Ministrave, anëtar i forumeve drejtuese të ndonjë partie politike, anëtar i Këshillit Drejtues të RTSH-së, pronar, bashkëpronar ose i punësuar i çfarëdo subjekti të mediave private.

Neni 11

Procedurat e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së

1. Kandidatët për postin e Drejtorit të Përgjithshëm, në zarf të mbyllur, te Kryetari i Këshillit Drejtues të RTSH-së, dokumentacionin, sipas kriterëve të shpallura, brenda 10 ditëve pas publikimit të tyre.

2. Këshilli Drejtues bën përzgjedhjen e kandidaturave të paraqitura në mbështetje të dokumentacionit të dorëzuar, verifikon dhe saktëson vërtetësinë e tyre dhe, më votim të fshehtë, vendos përfshirjen e tyre në konkurrim, duke i renditur sipas rendit alfabetik të mbiemrit. Më tej votohet për listën e pranuar, sipas procedurës së përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

3. Dy kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave kualifikohen për konkurrim të mëtejshëm. Shpallet fituese ajo kandidaturë që në votimin e parë të fshehtë të Këshillit Drejtues fiton dy të tretave e votave.

4. Në rast se asnjë nga kandidatët nuk fiton shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët për konkurrim paraqesin në Këshillin Drejtues, veç e veç, opsionet e tyre konkrete për strukturimin, drejtimin e menaxhimit të RTSH-së dhe japin shpjegime para Këshillit Drejtues.

5. Në rast se asnjëri nga dy kandidatët nuk fiton dy të tretat e votave, atëherë votimi përsëritet.

6. Kur pas votimit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk fiton numrin e votave të përcaktuar në ligj e në këtë statut, Këshilli Drejtues përsërit votimin pas tri ditësh.

7. Këshilli Drejtues shpall me vendim kandidatin fitues dhe e bën atë menjëherë të njohur për publikun.

Neni 12

Bordi i Administrimit

Emërimi, funksionimi, shpërndarja e Bordit të Administrimit bëhet në mbështetje të neneve

105 deri 111 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 13

Kriteret e zgjedhjes së Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, Drejtorit të TVSH-së, të RT-së dhe shefave të departamenteve

1. Kriteret për zgjedhjen e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, Drejtorit të TVSH-së, të RT-së dhe shefave të departamenteve, janë:

- a) të jenë shtetas shqiptar;
- b) të kenë kryer arsimin e lartë;
- c) të kenë përvojë pune ose drejtuese të drejtpërdrejtë në median e shkruar ose audiovizive jo më pak se 3 vjet;

ç) të kenë aftësi drejtues edhe ide të qarta për zhvillimin e një radioje dhe televizioni publik.

2. Kandidatët duhet t'i paraqesin Drejtorit të Përgjithshëm curriculum vitae të plotë, platformën dhe strukturën programore e organizative për vendin drejtues ku kandidojnë.

3. Zëvendës drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i TVSH-së, Drejtori i RT-së dhe shefat e departamenteve nuk lejohet të jenë në të njëjtën kohë deputetë, anëtarë të Këshillit të Ministrave, anëtarë të forumeve drejtuese të ndonjë partie, anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së, pronarë, bashkëpronarë ose anëtarë të çfarëdo subjekti të mediave private.

Neni 14

Procedurat e zgjedhjes

1. Procedurat për zgjedhjen Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, Drejtorit të TVSH-së, të RT-së dhe shefave të departamenteve, janë:

a) Drejtori i Përgjithshëm, në bazë të kriterëve, të përcaktuara në neni 13 të këtij statuti, bën studimin dhe përzgjedhjen e kandidaturave dhe për çdo nivel drejtimi, si rregull, i paraqet Këshillit Drejtues më shumë se një kandidat.

b) Këshilli Drejtues, kur e çmon të nevojshme, i kërkon Drejtorit të Përgjithshëm sqarime plotësuese për kandidatët.

c) Kandidatët votohen sipas radhës së propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Kur kandidati i parë nuk fiton shumicën e thjeshtë të votave, kalohet në votimin e kandidatit pasardhës.

ç) Nëse asnjëri nga kandidatët e votuar veç e veç nuk fiton me shumicën e thjeshtë të votave, atëherë bëhet votimi përfundimtar dhe shpallet fitues kandidati që merr më shumë vota.

d) Në mungesë të kandidaturave alternative, Këshilli Drejtues voton edhe një kandidaturë të vetme, me kusht që personi i propozuar të marrë votat e nevojshme.

2. Këshilli Drejtues shpall fituesit me vendim, të cilin e bën publik.

Neni 15

Motivet dhe procedurat e largimit nga detyra

1. Rastet për shkarkimin e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, Drejtorit të TVSH-së, Drejtorit të RT-së dhe shefave të departamenteve, ndërmerren:

a) kur provohet se është pengesë në zbatimin e detyrimeve që ngarkon ligji nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”;

b) kur aplikon praktika të reformës institucionale dhe praktika punësimi të pambështetura në ligj dhe në aktet e tjera që rregullon marrëdhëniet e punës;

c) kur personat e sipërpërmendur, në mënyrë të përsëritur, thyejnë ose nuk zbatojnë vendimet dhe rregulloret e miratuara nga Këshilli Drejtues;

ç) kur me veprimet ose mosveprimet e tyre sjellin dëme të konsiderueshme financiare dhe programore në veprimtarinë e RTSH-së.

2. Procedurat për shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm ndërmerren me nismën e Këshillit Drejtues, kur për këtë gjë shprehen me shkrim një e treta e anëtarëve të këtij Këshilli. Për Zëvendës drejtorin e Përgjithshëm, Drejtorin e TVSH-së dhe Drejtorin e RT-së, kjo procedurë nis me

propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

KREU IV KOMPETENCAT E ORGANEVE DREJTUESE TË RTSH-SË

Neni 16 **Këshilli Drejtues i RTSH-së**

1. Këshilli Drejtues i RTSH-së, në përputhje me nenin 99 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", ka këto kompetenca:

a) Miraton strategjitë për zhvillimin e RTSH-së dhe marrëdhëniet e këtij institucioni, brenda dhe jashtë vendit, të paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm dhe i kërkon këtij të fundit të raportojë periodikisht për zbatimin e tyre.

b) Miraton strukturën organizative e programe.

c) Shprehet publikisht për transmetime, programe dhe qendrimet të organeve të tjera drejtuese të RTSH-së dhe të stafit të tij, të cilat bien në kundërshtim me ligjin dhe aktet e tjera, që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.

ç) Miraton, ndryshon dhe shfuqizon rregulloret e veçanta të funksionimit të njësive përbërëse të RTSH-së.

d) Në çdo fillim viti, por jo më vonë se 15 marsi, në bazë të raportit të Bordit të Administrimit, analizon raportin financiar të RTSH-së dhe e depoziton atë pranë KKRT-së. Jep njoftim publik për rezultatet e analizës financiare.

dh) Miraton planin vjetor financiar dhe buxhetin e RTSH-së e të njësive përbërëse të tij.

e) Përcakton masën e shpërblimit mujor për Bordin e Administrimit.

ë) Miraton bashkëpunimin RTSH-së në projekte të rëndësishme të veçantë me interes kombëtar, si dhe të gjitha veprimtaritë e tjera me një vlerë ekuivalente projekti mbi 1 për qind të buxhetit vjetor të RTSH-së.

f) Me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm përcakton me akte të veçanta marrëdhëniet e ndërvlerësishme ndërmjet hallkave organizative të sistemit të RTSH-së, organizimin e RTSH-së, numrin e punonjësve në çdo njësi e hallkë dhe përshkrimin e punës së tyre, si dhe metodën e punës e të veprimtarive financiare, të biznesit dhe të shërbimeve. Në përputhje me këto vendime, Këshilli Drejtues kërkon reflektimin me rregullore të brendshme të çdo njësie.

g) Këshilli Drejtues thërret në raport drejtuesit e niveleve të ndryshme në sistemin e RTSH-së.

gj) Të gjitha procesverbalet, që mbahen në mbledhjet që zhvillon Këshilli Drejtues, ruhen në arkiv për dhjetë vjet.

h) Këshilli Drejtues propozon për largimin nga detyra të anëtarit të vet, kur ai nuk merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues për 6 muaj rresht.

i) Procedura e largimit nga detyra, në mbështetje të shkronjës "h" të këtij neni, bëhet si në rastet e zgjedhjes së anëtarit të Këshillit Drejtues.

Neni 17 **Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së**

Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, në përputhje me nenin 102 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", ka këto kompetenca:

a) I propozon Këshillit Drejtues për emërim apo largim nga puna të Zëvendës-drejtorit të Përgjithshëm, të Drejtorit të Radio Tiranës, të Drejtorit të Televizionit Shqiptar, të Drejtorit të Drejtorisë së Aktualitetit, të drejtorëve të radiove vendore, si dhe drejtuesve të stacioneve transmetuese.

b) I paraqet për miratim Këshillit Drejtues strukturat organizative programore dhe planin financiar e të biznesit të RTSH-së.

c) Çdo muaj në mbledhjen e drejtorëve bën orientimin dhe analizën e realizimit të planeve mujore.

ç) I raporton me shkrim Këshillit Drejtues, të paktën një herë në katër muaj, për realizimin e planeve të zhvillimit të programeve e të biznesit.

d) Është titullar i entit prokurues “Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH)”. Në mungesë të tij, këtë përgjegjësi ia delegon Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm.

dh) U delegon me shkrim drejtorëve të të gjitha niveleve përgjegjësi për periudha të caktuara kohore.

e) Kontrollon programacionin.

ë) Është përgjegjës, së bashku me strukturat vartëse përkatëse, për përputhshmërinë e programit informativ me parimet e përcaktuara në ligjin nr.8410, datë 30.9.1999 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" dhe në këtë statut.

f) Emëron, shkarkon apo largon nga puna, me propozim të Drejtorit të RT-së ose të TVSH-së, punonjës me kohë të pjesshme ose të punësuar në bazë të një kontrate projektfinancimi, nëse projekti apo kontrata përfshijnë si Radion dhe Televizionin. Në këto raste ai njofton Këshillin Drejtues.

g) Ndërhyn për ndryshime apo për bllokim të programit në transmetim, kur e shihet të arsyeshme, në rast se ka emergjencë kombëtare ose vërehen shkelje të të drejtave të njeriut dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve.

Neni 18

Bordi i Administrimit të RTSH- së

Bordi i Administrimit të RTSH-së është organ këshillimor i Drejtorit të Përgjithshëm, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 113 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” për çështjet e administrimit dhe për çështjet financiare e të biznesit të RTSH-së.

Neni 19

Kompetencat e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto kompetenca:

a) Përpilon projektbuxhetin vjetor të RTSH-së.

b) Harton bilancin financiar vjetor, me të dhënat e paraqitura nga Drejtoria Ekonomiko-financiare, brenda afateve të përcaktuara në ligj.

c) Jep mendim për shpenzimet e paparashikuara në buxhet.

ç) I paraqet Drejtorit të Përgjithshëm raportin për shpenzimet dhe të ardhurat e RTSH-së, në formë raportesh financiare, mujore, tremujore dhe gjashtëmujore, pasi ka marrë të dhënat e nevojshme nga departamentet dhe sektorët e RTSH-së.

dh) Shqyrton kontratat, shuma e të cilave kalon 5 për qind të buxhetit vjetor të RTSH-së.

Neni 20

Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm

1. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm ushtron të gjitha përgjegjësitë me të drejtë vendimmarrje, kur autorizohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

2. Në veprimtarinë e përditshme ka detyrë funksionale ndjekjen operative të departamenteve të Marrëdhënieve me Publikun, të Administratës dhe atë të Personelit. Me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues shqyrton dhe vendos detyra shtesë për Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm.

3. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm ushtron të gjitha përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm, kur ky post mbetet vakant.

Neni 21

Drejtori i Televizionit Shqiptar

Drejtori i Televizionit Shqiptar ka këto kompetenca:

a) Përgjigjet për veprimtarinë krijuese, programore dhe ekonomiko-financiare të TVSH-së.

b) Harton dhe mbron para Drejtorit të Përgjithshëm dhe Këshillit Drejtues të RTSH-së strukturën programore, planin e prodhimit të programeve dhe planin e zhvillimeve, me limitet e

financimit të tyre.

c) Drejton dhe bashkërendon punën në departamentet për zbatimin e planeve të programeve dhe zgjidh konfliktet ndërmjet tyre, miraton planet javore, mujore, tremujore dhe ndryshimet në planet ditore të transmetimit.

ç) I raporton çdo muaj me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e planeve të zhvillimit të programeve e të biznesit

d) Harton Rregulloren e TVSH-së dhe ia paraqet për shqyrtim Drejtorit të Përgjithshëm.

dh) Miraton të gjitha rregulloret e brendshme të sektorëve administrative, të krijimtarisë dhe të teknikës në TVSH.

e) Është titullar i entit prokurues “Televizioni Shqiptar (TVSH)” dhe, në mungesë të tij, këtë përgjegjësi ia delegon Zëvendësdrejtorit të Televizionit.

ë) Miraton projekte me vlerë financiare deri në 1 për qind të buxhetit vjetor të TVSH-së, që financohen nga institucione ose organizma të tjera qendrore e vendore.

f) Emëron, liron nga detyra ose largon nga puna, duke përfshirë marrjet në punë me kohë të pjesshme ose në bazë të një kontratë projektfinancimi, vendos për shpërblimet ose masat disiplinore për të gjithë punonjësit në varësi të tij, me propozimin e drejtorëve të departamenteve dhe të shefave të sektorëve. Për të gjitha këto vë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm. Për lidhjen e kontratave me kohë të pjesshme dhe me projektfinancimi nevojitet mendimi i Drejtorit të Përgjithshëm dhe për to njoftohet Këshilli Drejtues.

Neni 22

Drejtori i Radio Tiranës

Drejtori i Radio Tiranës ka këto kompetenca:

a) Përgjigjet për veprimtarinë krijuese, programore dhe ekonomiko-financiare të RT- së.

b) Harton dhe mbron, para Drejtorit të Përgjithshëm dhe Këshillit Drejtues të RTSH-së, strukturën programore vjetore, planin e prodhimit të programeve dhe planin e zhvillimit të RT-së, me limitet e financimit të tyre.

c) Drejton dhe bashkërendon punën me departamentet e RT-së.

ç) Çdo tre muaj i raporton me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm realizimin e planeve të zhvillimit të programeve e të biznesit.

d) Drejton hartimin e rregullores së RT-së dhe ia paraqet për shqyrtim Drejtorit të Përgjithshëm.

dh) Miraton të gjitha rregulloret e brendshme të sektorëve administrativë të krijimtarisë dhe të teknikës në RT.

e) Miraton planet javore, mujore, tremujore, si dhe ndryshimet në planet ditore të programeve të transmetimit.

ë) Është titullar i entit prokurues “Radio Tirana (RT)” dhe, në mungesë të tij, këtë përgjegjësi ia delegon Zëvendësdrejtorit të RT-së.

f) Miraton projekte me vlerë financiare deri në 1 për qind të buxhetit vjetor të RT-së, që financohen nga institucione ose organizma të tjerë qendrorë e vendorë.

g) Emëron, liron nga detyra ose largon nga puna, duke përfshirë marrjet në punë me kohë të pjesshme ose në bazë të një kontrate projektfinancimi, vendos për shpërblimet ose masat disiplinore për të gjithë punonjësit në varësi të tij me propozimin e drejtorëve të departamenteve dhe të shefave të sektorëve. Për të gjitha këto vihet në dijeni Drejtori i Përgjithshëm. Për lidhjen e kontratave me kohë të pjesshme dhe me projektfinancimi nevojitet mendimi i Drejtorit të Përgjithshëm dhe për to njoftohet Këshilli Drejtues.

Neni 23

Zëvendësdrejtori i Radio Tiranës dhe ai i Televizionit Shqiptar

Zëvendësdrejtori i Radio Tiranës dhe ai i Televizionit Shqiptar kanë këto kompetenca:

a) Ushetrojnë të gjitha kompetencat me të drejtë vendimmarrje, kur autorizohen nga drejtuesit përkatës.

b) Ushetrojnë të gjitha kompetencat e Drejtorit të RT-së dhe të TVSH-së kur postet e tyre

ngelen vakant.

c) Në veprimtarinë e përditshme realizojnë ndjekje operative të sektorëve në vartësi, të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të RTSH-së.

Neni 24

Drejtori i departamentit

Drejtori i departamentit ka këto kompetenca:

- a) Drejton dhe menaxhon veprimtarinë e departamentit.
- b) Harton dhe i propozon, sipas rastit, Drejtorit të Radios ose të Televizionit strukturën programore të departamentit, numrin e punonjësve dhe ngarkesën e tyre.
- c) Bën planin ekonomik të shpenzimeve dhe menaxhon projektet prodhuese të sektorit të tij.
- ç) Përgjigjet për shpenzimet e kryera nga punonjësit gjatë përmbushjes së detyrës së tyre.
- d) Përgjigjet për veprimtarinë programore të departamentit, harton planet ditore, javore, mujore, tremujore të prodhimit.
- dh) Ruan një kopje të dokumentacionit të prodhimit.
- e) Kontrollon dhe mban përgjegjësi për materialet e transmetuara, të cilat nuk mund të transmetohen pa firmën e tij.
- ë) I raporton Drejtorit të Radios ose të Televizionit, strukturë e të cilit është departamenti, për shpenzimet, nevojat për financim dhe përdorimin e sponsorizimit.
- f) I propozon Drejtorit të Radios ose të Televizionit emërimin, largimin, vlerësimet për shpërblim dhe jep masa disiplinore për punonjësit në varësi të tij.

KREU V

MARRËDHËNIET E PUNËS DHE KATEGORITË E PUNONJËSVE NË SISTEMIN E RTSH-SË

Neni 25

Marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, si dhe me ligje të tjera që rregullojnë këto marrëdhënie.

Neni 26

1. Marrëdhëniet e punës rregullohen me kontrata pune:

- a) individuale;
 - b) kolektive;
 - c) me kohë të pjesshme, ku parashikohet garantimi i sigurimeve shoqërore nga institucioni;
 - ç) me projekte, ku detyrimet financiare mbulohen nga vetë projekti.
2. Marrja në punë bëhet sipas kriterëve të pranimit në punë të miratuara nga Këshilli Drejtues.
3. Largimi nga puna bëhet:
- a) sipas kriterëve të përcaktuara në Kodin e Punës;
 - b) me mbarimin e kontratës ;
 - c) për shkelje flagrante të disiplinës në punë;
 - ç) për përvetësim të pasurisë së RTSH-së;
 - d) me kërkesën e të punësuarit.

Neni 27

1. Punonjësit të RTSH-së i ndalohet të shpërndajë ose të publikojë çdo material kofidencial që është siguruar në funksion të postit ose detyrës që mban.

2. Rastet e ndodhura vlerësohen në vartësi të rrjedhøjave dëmtuese dhe struktura drejtuese ushtron të drejtën e masave ndëshkimore.

3. Ndalohet dypunësimi i punonjësve të sektorëve programorë e krijues, të sektorëve të teknikës dhe të specialistëve të tjerë të administratës së RTSH-së në mediat e tjera jopublike, që

cenojnë interesat e RTSH-së.

Neni 28

Punonjësit në sistemin e RTSH-së grupohen në:

- a) punonjësit e sektorit të krijimtarisë;
- b) punonjësit e sektorit teknik;
- c) punonjësit e sektorit ekonomiko- administrativ;

2. Në grupin e parë përfshihen të gjithë punonjësit e RTSH-së, që merren me punë krijuese, si: gazetarë, regjisorë, redaktorë, redaktorë muzike, operatorë, kameramanë, piktorë etj., që merren në punë me kontratë afatgjatë, me kohë të pjesshme dhe me kontratë projektfinancimi. Kontrata me kohë të pjesshme dhe projektfinancimi për punonjësit jashtë RTSH-së aplikohen vetëm nëse punonjësit e brendshëm nuk janë të aftë të drejtojnë programe të specifikuara në kontratë, me arsye të shprehura qartë, ose nëse këto programe drejtohen nga profesionistë të jashtëm me arritje të spikatura. Punonjësit me kohë të pjesshme ose ata të punësuar në bazë të një kontrate projektfinancimi duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në përshkrimet përkatëse të punës.

3. Në grupin e dytë përfshihen të gjithë ata që merren me problemet teknike të prodhimit, regjistrimit dhe të transmetimit radioteleviziv.

4. Në grupin e tretë përfshihet i gjithë stafi drejtues i RTSH-së, si dhe të gjithë ata që janë në shërbim të administratës dhe që kryejnë detyra shërbimi për të dyja grupet e para, si punonjës shërbimi, hidraulikë, marangozë, elektrikistë, korrierë, sekretarë, arkivistë, roje shërbimi etj.

Neni 29

Përshkrimi i punës për secilën nga kategoritë e përcaktuara në nenin 28 bëhet me këtë statut, si dhe me rregullore të veçantë, të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Neni 30

Drejtori i Drejtorisë së Aktualitetit

1. Drejtori i Drejtorisë së Aktualitetit propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe miratohet nga Këshilli Drejtues i RTSH-së. Drejtori i Drejtorisë së Aktualitetit ka të njëjtat kriteret përzgjedhjeje dhe procedurë si Drejtori i RT-së dhe i TVSH-së.

2. Drejtori i Drejtorisë së Aktualitetit ka të njëjtat kompetenca me ato të Drejtorit të RT-së dhe të TVSH-së. Ai ka edhe këto detyra:

- a) Bën planizimin e lajmeve.
- b) Siguron bashkërendimin e lajmeve mes radios dhe televizionit.
- c) Realizon shkëmbimin e informacionit, përfshirë shërbimet kabllore dhe idetë për mbulimin e ngjarjeve.
- d) Siguron një mbulim të qëndrueshëm dhe autoritar me lajme nga ana e RTSH-së, për Televizionin Shqiptar dhe Radio Tiranën, duke iu ofruar shërbime edhe radiove vendore, në bazë të ruajtjes së politikave të redaksive.

Neni 31

Drejtori i Burimeve Teknike dhe i Zhvillimit

Kompetencat e Drejtorit të Burimeve Teknike dhe të Zhvillimit përcaktohen në këtë Statut dhe në Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së. Drejtori i Burimeve Teknike dhe të Zhvillimit:

- a) përgjigjet për gjendjen teknike, shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese dhe transmetuese të teknikës së RTSH-së, për projektet zhvillimore dhe bizneset e këtij sektori;
- b) harton dhe mbron para Drejtorit të Përgjithshëm, në bashkëpunim me drejtorët e RT-së dhe të TVSH-së, si dhe të qendrave rajonale, planet teknike të prodhimit të studiove të radiotelevizionit dhe të transmetimit të programeve nga transmetuesit, përsëritësit dhe radioreletë e radiotelevizionit;
- c) drejton dhe bashkërendon punën me sektorët teknikë të TVSH-së, RT-së, si dhe të

qendrave rajonale;

ç) harton dhe mbron para Drejtorit të Përgjithshëm plane biznesi për përdorim për të tretë të kapaciteteve të lira teknike, prodhuese dhe transmetuese;

d) harton planin vjetor të zhvillimeve teknike dhe të investimeve të RTSH-së dhe kufijtë e financimit të tyre, në bashkëpunim me strukturat e tjera organizative të RTSH-së;

dh) drejton veprimtarinë e shërbimeve teknike me telefon, radio, kompjuter, mirëmbajtje infrastrukturë e pajisje teknike dhe planifikon shpenzimet vjetore për to;

e) i raporton me shkrim çdo tre muaj Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e planeve të zhvillimit, të investimit dhe të biznesit teknik;

ë) harton Rregulloren e Drejtorisë së Burimeve Teknike dhe të Zhvillimit, në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së dhe ia paraqet për shqyrtim Drejtorit të Përgjithshëm;

f) miraton të gjitha rregulloret e brendshme të sektorëve teknikë që janë në përbërje të strukturave organizative të RTSH-së;

g) propozon emërimin dhe largimin nga puna, shpërblimet dhe masat disiplinore të drejtuesve e specialistëve të sektorëve teknikë.

Neni 32

Drejtori i Financave

Funksioni, kriteret e emërimit dhe të shkarkimit dhe kompetencat e Drejtorit të Financave përcaktohen në këtë Statut dhe në Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së. Drejtori i Financave:

a) përgjigjet për gjendjen financiare të të ardhurave e shpenzimeve të sistemit të RTSH-së;

b) përgatit në bashkëpunim me drejtoritë e programeve radiotelevizive, sektorët teknikë e të prodhimit, buxhetet e specifikuara vjetore të çdo njësie organizative të RTSH-së, buxhetin vjetor të RTSH-së dhe ia paraqet për veprim të mëtejshëm Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit të Administrimit;

c) përgatit në bashkëpunim me drejtoritë e programeve radiotelevizive, sektorët teknikë dhe të prodhimit bilancet vjetore të çdo njësie të veçantë organizative dhe bashkë me të dhënat për bilancin vjetor të RTSH-së, ia paraqet për veprim të mëtejshëm Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit të Administrimit;

ç) mbikëqyr dhe kontrollon realizimin e buxheteve në çdo njësi organizative të RTSH-së, nëse janë përdorur në përputhje me vendimet e marra dhe i propozon me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit të Administrimit masat përkatëse;

d) nxjerr kostot e prodhimit, të shërbimeve e shpenzimeve, i përpunon ato dhe ia paraqet me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit të Administrimit;

dh) ndjek sistematikisht realizimin e të ardhurave të RTSH-së, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligj e në këtë Statut, në marrëveshje e kontrata biznesi me të tretë, i përpunon ato dhe ia paraqet, me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit të Administrimit, çdo tre muaj;

e) ndjek sistematikisht realizimin e detyrimeve financiare e të shpenzimeve të RTSH-së të përcaktuara në ligj, në këtë Statut dhe në marrëveshjet e kontratat e biznesit të RTSH-së, i përpunon ato dhe ia paraqet me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit të Administrimit, të paktën çdo tre muaj;

ë) në bashkëpunim me Drejtorin e Burimeve Teknike e të Zhvillimit harton projekte tarifash për prodhimet radiotelevizive e shërbimet për të tretë dhe ua paraqet ato organeve vendimmarrëse të RTSH-së;

f) harton Rregulloren e Drejtorisë së Financës, të strukturave vartëse financiare dhe ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm për veprim të mëtejshëm;

g) merr pjesë në procesin e vendimmarrjes dhe shpreh qëndrimin e tij për sa ka të bëjë me veprimtarinë e mësipërme.

Neni 33

Drejtori i Marketingut

Drejtori i Marketingut ka këto kompetenca:

a) Përgjigjet për rritjen e të ardhurave të RTSH-së nëpërmjet reklamave e sponsorizimeve, shitjes së vidiove, audiokasetave dhe kompaktdisqeve, si dhe lëshimit me qera të transmetuesve, studiove dhe pajisjeve teknike.

b) Studion tregun e reklamave dhe koniunkturat e tij dhe i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit të Administrimit propozime me shkrim për tarifa, për procedurat e komisionimit të kohës së shitur për reklamë, për sponsorizime, për shërbime për të tretë dhe vepron sipas vendimeve të marra nga organet e vendimmarrjes.

c) Në bashkëpunim me Drejtorin e Burimeve Teknike e të Zhvillimit harton projektkontrata biznesi me të tretë për shfrytëzimin e kapaciteteve të lira prodhuese e transmetuese.

ç) Në bashkëpunim me Drejtorin e Financave ndjek realizimin e kontratave të lidhura.

d) Harton Rregulloren e Brendshme të Drejtorisë së Marketingut dhe ia paraqet Bordit të Administrimit për veprim të mëtejshëm.

dh) Propozon shpërblime për punonjësit kur tejkalohen të ardhurat, si dhe merr masa ndëshkuese për shpërdoruesit.

Neni 34

Drejtori i Administratës dhe ai i Personelit

1. Drejtori i Administratës dhe ai i Personelit mbajnë lidhje të drejtpërdrejta me Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm. Në detyrën e tyre ata:

a) përgjigjen për zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues e të Drejtorit të Përgjithshëm lidhur me kriteret, procedurat e detyrimet të parashikuara në to e në kontratat e punës për rekrutimin, trajnimin e motivimin e punonjësve;

b) në bashkëpunim me drejtuesit e tjerë të niveleve paralele dhe me miratim të drejtuesve më të lartë, hartojnë programe të qarta trajnimi për punonjësit sipas vendit të punës;

c) këmbëngulin të zbatohet një politikë e drejtë punësimi, duke mbështetur individët më të aftë dhe të njohur në publik, si dhe duke thithur forca të reja krijuese, mbi bazë kriteresh të qarta dhe përshkrimesh të detajuara për çdo vend pune;

ç) hartojnë modalitetet për zënien e vendeve të lira të punës, duke i reklamuar ato brenda dhe jashtë RTSH-së dhe duke aplikuar intervista përpara një paneli të përbërë së paku nga Drejtori i Personelit dhe shefi i departamentit përkatës. Vendimi i komisionit merr fuqi vepruese pasi miratohet nga drejtorët përkatës të RT-së e TVSH-së ose të njëjësive vendore;

d) shqyrtojnë kontratat e përkohshme e afatshkurtra të stafit e të drejtuesve dhe kërkojnë të saktësohet në to puna që do të kryejë secili, përgjegjësia, paga, e drejta për pushim, detyrimet ndaj punëdhënësit, orët e domosdoshme të punës, rregullat e brendshme dhe masat disiplinore;

dh) bëjnë propozime për sistemin e pagave, shkallëzimet sipas vendeve të punës dhe fleksibilitetet e duhura;

e) ruajnë dokumentacionin e plotë të strukturave organike, emërtimin për çdo vend pune dhe veprojnë në përputhje me aktet e nxjerra nga organet vendimmarrëse;

ë) ruajnë e plotësojnë rregullisht dokumentet e punëmarrësve të përhershëm dhe me kontrata afatshkurtëra, sipas kërkesave të këtij Statuti dhe të Kodit të Punës;

f) marrin pjesë në mbledhjet e organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme dhe Këshilli Drejtues, kur diskutohet dhe vendoset për drejtimet që kanë të bëjnë me detyrat e tyre.

2. Drejtori i Personelit harton Rregulloren e Drejtorisë së Personelit dhe ia paraqet Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm për veprim të mëtejshëm.

Neni 35

Drejtorët e qendrave rajonale

Drejtorët e radiove vendore të RSh-së, RKu-së, RGj-së dhe RKo-së kanë këto kompetenca:

a) Organizojnë dhe drejojnë veprimtarinë e radios vendore.

b) Hartojnë dhe përgjigjen për administrimin e buxhetit të akorduar radios vendore që drejojnë.

c) Përgjigjen për veprimtarinë programore të radios, miratojnë planet ditore, javore, mujore dhe tremujore të prodhimit.

- ç) Ruajnë një kopje të dokumentacionit të prodhimit.
- d) Hartojnë dhe mbrojnë përpara organeve drejtuese të RTSH-së strukturën programore, planin e prodhimit të programeve dhe mënyrën e transmetimit vendor të tyre.
- dh) Zbatojnë planin e transmetimeve kombëtare në radio dhe në televizion për zonat që mbulon qendra rajonale.
- e) Ndjekin realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve që rrjedhin nga zbatimi i kontratave me të tretë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Burimeve Teknike dhe të Zhvillimit.
- ë) Hartojnë rregulloren e radios vendore dhe ia paraqesin për shqyrtim Drejtorit të Përgjithshëm.
- f) Ndjekin zbatimin e programit të hartuar nga RT - ja dhe TVSH-ja për lidhje me radio e televizion nga zonat që mbulon radioja vendore.
- g) Propozojnë emërimin dhe largimin nga puna, përveç kryeinxhinierit dhe kryeredaktorit, si dhe shpërblimet e masat disiplinore për punonjësit në vartësi të tyre.
- gj) Raportojnë me shkrim çdo muaj në drejtorinë përkatëse defektet teknike dhe ndërprerjet e transmetimeve kombëtare të Radios dhe Televizionit.

Neni 36

Drejtori i Drejtorisë së Stacioneve të RTV-së

Drejtori i Drejtorisë së Stacioneve të RTV-së Durrës, Elbasan, Tiranë ka këto kompetenca:

- a) Organizon dhe drejton veprimtarinë e Drejtorisë së Stacioneve të RTV-së.
- b) Harton dhe përgjigjet për administrimin e buxhetit të akorduar Drejtorisë së Stacioneve që drejton.
- c) Përgjigjet për transmetimet radiotelevizive të programeve kombëtare të Radios dhe Televizionit për zonat që mbulon Drejtoria e Stacioneve.
- ç) Ndjek realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve që rrjedhin nga zbatimi i kontratave me të tretë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Burimeve Teknike dhe të Zhvillimit.
- d) Ndjek zbatimin e programit të hartuar nga RT-ja dhe TVSH-ja për lidhje me radio e televizion nga zonat që mbulon Drejtoria e Stacioneve.
- dh) Harton rregulloren e Drejtorisë së Stacioneve të RTV-së dhe e paraqet për shqyrtim në Drejtorinë e Përgjithshme.
- e) Miraton planet mujore të sektorëve përbërës të Drejtorisë së Stacioneve.
- ë) Raporton me shkrim çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme për defektet teknike dhe ndërprerjet e transmetimeve kombëtare të Radios dhe Televizionit.
- f) Propozon emërimin dhe largimin nga puna, shpërblime dhe masa disiplinore për punonjësit në vartësi të tij.

Neni 37

Drejtori i njësisë së prodhimit në TVSH (kryeinxhinieri)

Kryeinxhinieri i TVSH-së ka këto kompetenca:

- a) Organizon dhe drejton veprimtarinë e njësisë së prodhimit, të teknikës së TVSH-së e cila është njësi e veçantë organizative brenda strukturës së TVSH-së dhe prodhon programe televizive të porositura ose të kërkuara nga departamentet e tij të programit të parë, të dytë dhe atij satelitor.
- b) Harton dhe përgjigjet për administrimin e buxhetit të akorduar njësisë së prodhimit televiziv.
- c) Realizon planin vjetor të prodhimit, si dhe porosi të tjera të departamenteve të TVSH-së të miratuara nga organet drejtuese të RTSH-së.
- ç) I raporton me shkrim çdo muaj Drejtorit të TVSH-së dhe Drejtorit të Burimeve Teknike dhe të Zhvillimit realizimin e planeve të prodhimit.
- d) Përgjigjet për shfrytëzimin racional të studiove të prodhimit, të montazhit dhe atyre lëvizëse të TVSH-së.
- dh) Harton rregulloren e njësisë së prodhimit në TVSH dhe e paraqet për shqyrtim në Drejtorinë e Përgjithshme.

e) Propozon emërimin, largimin nga puna, shpërblime dhe masa disiplinore për stafin inxhiniero-teknik në vartësi të tij.

Neni 38

Drejtori i njësisë së prodhimit në RT (kryeinxhinieri)

Kryeinxhinieri i RT-së ka këto kompetenca:

a) Organizon dhe drejton veprimtarinë e njësisë së prodhimit, të teknikës së RT-së, e cila është njësi e veçantë organizative brenda strukturës së RT-së dhe prodhon programe radiofonike të porositura nga departamentet e saj të programit të parë, të dytë, të bashkatdhetarëve dhe të jashtëm.

b) Harton dhe përgjigjet për administrimin e buxhetit të akorduar njësisë së prodhimit radiofonik.

c) Realizon planin vjetor të riprodhimit, si dhe porosi të tjera të departamenteve të RT-së të miratuara nga organet drejtuese të RTSH-së.

ç) I raporton me shkrim çdo muaj Drejtorit të RT-së dhe Drejtorit të Burimeve Teknike dhe të Zhvillimit realizimin e planeve të prodhimit.

d) Përgjigjet për shfrytëzimin racional të studiove të prodhimit, të montazhit, atyre lëvizëse dhe të prodhimit muzikor.

dh) Harton rregulloren e njësisë së prodhimit në RT dhe e paraqet për shqyrtim në Drejtorinë e Përgjithshme.

e) Propozon emërimin, largimin nga puna, shpërblime dhe masa disiplinore për stafin inxhiniero-teknik në vartësi të tij.

KREU VI

VEPRIMTARIA DHE PROGRAMET E RTSH-SË

Neni 39

Veprimtaria e RTSH-së

1. Veprimtaria e RTSH-së bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", në këtë statut, në vendimet e Këshillit Drejtues të RTSH-së dhe urdhërat e vendimet e Drejtorit të Përgjithshëm. RTSH-ja, në veprimtarinë e vet, respekton legjislacionin shqiptar, konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare për veprimtarinë radiofonike dhe televizive, të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

2. Veprimtaria e RTSH-së përfshin përgatitjen, prodhimin e transmetimin:

a) e dy programeve kombëtare të televizionit;

b) e një programi televiziv për transmetim satelitor;

c) e dy programeve (programi i parë dhe i dytë) kombëtare të Radio Tiranës;

ç) e një programi të Radio Tiranës për bashkatdhetarët;

d) e një programi të Radio Tiranës për publikun e huaj;

dh) e katër programeve rajonale radioje e televizive: Shkodër, Kukës, Korçë, Gjirokastrë.

Neni 40

Programet e RTSH-së

1. Programet e RTSH-së respektojnë kërkesat e neneve 35 deri 47 dhe të neneve 66 deri 71 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilave ata:

a) kanë karakter informativ, edukativ, kulturor, dhe artistiko-argëtues;

b) respektojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut, paanshmërinë dhe objektivitetin e informacionit, të drejtat e fëmijëve, gjuhën dhe kulturën shqiptare, të drejtat kushtetuese të shtetasve dhe të pakicave kombëtare, përkatësinë fetare shqiptare, rendin publik dhe sigurinë kombëtare, gjuhën

e kulturën shqiptare, të drejtat kushtetuese të shtetasve e të pakicave kombëtare, si dhe dallimet fetare të shqiptarëve;

c) informojnë publikun, me objektivitet dhe profesionalizëm, për ngjarjet në Shqipëri e në botë;

ç) përgatisin dhe realizojnë informacione me interes publik, që transmetohen pa shpërblim, për rastet e fatkeqësive natyrore, për shëndetin dhe rendin, vetëm me vendim me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm;

d) realizojnë shërbimin në shqip të programeve të huaja, të filmave artistike e të dokumentarëve;

dh) ruajnë fshehtësinë e burimit të informacionit;

e) njohin të drejtën e përgënjeshtimit;

ë) nuk nxisin dhunën, urrejtjen kombëtare, fetare e raciale, ndarjen territoriale dhe veprime antikushtetuese.

2. Planet e prodhimit të programeve miratohen nga drejtorët e departamenteve përkatëse.

3. Të gjitha materialet e përgatitura për transmetim regjistrohen e arkivohen.

4. Përgjegjës për programin e RTSH-së është gazetari përkatës dhe Drejtori i Departamentit.

KREU VII
SEKTORI TEKNIK DHE ORGANIZIMI I TIJ

Neni 41

Detyrat e Sektorit Teknik të RTSH-së

1 Sektori Teknik i RTSH-së siguron:

- a) prodhimin, riprodhimin e programeve televizive, transmetimin e tyre dhe mirëmbajtjen e aparaturave teknike të prodhimit e të transmetimit;
- b) transmetimin e programeve radiofonike e televizive në RT e TVSH, si dhe në radiot e televizionet vendore;
- c) shtrirjen e sistemit transmetues, për të arritur objektivat ligjorë;
- ç) shpërndarjen e sinjalit të radios e të TV-së, me qëllim që të garantohet, sipas detyrimeve ligjore, niveli i shikueshmërisë dhe i degjueshmërisë së programeve të transmetuara nga RTSH-ja dhe të operatorëve të tjerë, të përcaktuar në aktet normative si detyrime të sektorit teknik;
- d) hartimin e projekteve për modernizimin teknik të sistemit të prodhimit dhe të transmetimit;
- dh) planifikimin, ndërtimin dhe shërbimet inxhinierike;
- e) mirëmbajtjen e aparaturave dhe të pajisjeve;
- ë) ndjekjen çdo ditë të treguesve të shikueshmërisë dhe të degjueshmërisë së programeve të transmetuara nga RTSH-ja dhe nga organizatat e tjera, transmetimi dhe përhapja e të cilave i besohet sektorit teknik;
- f) matjet e parametrave teknike të transmetuesve, antenave dhe gjeneratorëve;
- g) shërbime dhe këshillime teknike në ndërtimin, vendosjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e lehtësirave dhe të aparaturave të RTSH-së, të pajisjeve video dhe audio të studiove e të rrjetit të transmetimit;
- gj) përgatitjen e dokumentacionit teknik për ndërtimin e infrastrukturës së studiove dhe të aparaturave transmetuese.

Neni 42

Drejtoria e Teknologjisë dhe e Bashkërendimit

1. Drejtoria e Teknologjisë dhe e Bashkërendimit ndodhet në Drejtorinë e Përgjithshme dhe përgjigjet për bashkërendimin e të gjithë punës në sektorin teknik të RTSH-së.
2. Ajo kontrollon gatishmërinë teknike të prodhimit dhe transmetimit, planifikon ndryshimet e teknologjive dhe njofton Drejtorin e Përgjithshëm për gjendjen e sistemit.
3. Përveç sektorëve teknike të RT-së dhe TVSH-së, sektorë të teknikës kanë edhe radiot vendore, çdo njëri prej të cilit bën prodhime programesh për llogari të institucionit të vet ose për të tretë dhe është në vartësi të drejtorit të institucionit përkatës.

Neni 43

Stacionet transmetuese në RTV

Drejtoria e Stacioneve Transmetuese ka për detyrë të transmetojë programet e RTSH-së dhe të sigurojë sinjal cilësor për të gjithë klientët.

KREU VIII
PRODHIMI DHE RIPRODHIMI ARTISTIK

Neni 44

1. RTSH-ja do të vazhdojë të jetë prodhuesi kryesor i programeve të veta të Radios e Televizionit, duke kaluar, shkallë-shkallë, në bashkëprodhime vetëm programesh edukative, kulturore, artistike dhe argëtuese me prodhues privatë, vendas dhe të huaj, dhe, në të ardhmen, mund të porosisë programe të prodhuara nga të tretët.
2. RT-ja prodhon programe radioje të të gjitha gjinive radiofonike. TVSH-ja prodhon

programe televizive të të gjitha gjinive dhe filma artistikë. Prodhimi i programeve të Radios dhe të Televizionit planifikohet dhe realizohet në përputhje me strukturën programore të miratuar.

3. Prodhimi financohet nga buxheti i RTSH-së, nga sponsorë ose donatorë të ndryshëm.

4. Prodhimi realizohet me projekte të hollësishme, me plane ekonomiko-financiare dhe me planskenare.

5. Bashkëprodhimi realizohet pas miratimit të planskenarit dhe të buxhetit të programit dhe, në asnjë rast, bashkëprodhimi nuk duhet të jetë me humbje për RTSH-në.

Neni 45

Të gjitha departamentet krijuese në RTSH janë sektorë prodhues.

Neni 46

1. Brenda strukturës së Radio Tiranës vepron orkestra simfonike e RTSH-së dhe informacioni i vogël muzikor, të cilët, përveç veprimtarisë koncertale për publikun, prodhojnë programe muzikore për fonotekën dhe arkivin e TVSH-së, si dhe kryejnë shërbime me porosi të të tretëve.

2. Orkestra ka për qëllim:

a) riprodhimin e veprave muzikore shqiptare e të huaja dhe prodhimin e regjistrimeve të muzikës së lehtë dhe popullore;

b) përgatitjen dhe shfaqjen e koncerteve dhe të shfaqjeve të tjera publike;

c) regjistrimin e krijimeve artistike të vendit dhe të huaja;

ç) koncertet mujore, festivalet dhe krijimtari të tjera.

Neni 47

1. Radiot dhe televizionet vendore prodhojnë, përgatisin dhe transmetojnë programe radioje dhe televizive për rajonet që mbulojnë, si dhe programe të porositura informative për Radio Tiranën, TVSH-në dhe për të tretët.

2. Programet e radiove dhe televizioneve rajonale përgatiten nga redaksitë përkatëse.

3. Përgatitja e programeve rajonale të radios dhe të televizioneve drejtohet nga përgjegjësi i radios rajonale dhe bashkërendohet me Drejtorin e Radio Tiranës dhe Drejtorin e Televizionit Shqiptar.

Neni 48

Prodhimi i programeve të radiove dhe të televizioneve vendore drejtohet nga drejtorët e programeve të këtyre institucioneve, në bashkëpunim me redaktorët përgjegjës të programeve, duke zbatuar strukturën programore, të miratuar nga Këshilli Drejtues i RTSH-së.

Neni 49

1. RTSH-ja kryen këto shërbime për vete dhe për të tretët:

a) Prodhon kaseta, vidiokaseta dhe CD për vete dhe për të tretët.

b) Prodhon e transmeton mesazhe tregtare, reklama dhe shërbime reklamash në programet e Radios dhe të Televizionit.

c) Organizon marketingun e filmave televizive, të programeve të Radios dhe Televizionit dhe të regjistrimeve muzikore në tregjet vendase dhe të huaja.

ç) Organizon blerjen, shitjen, shkëmbimin e dhënien me qira të filmave dhe videofilmave, si dhe të programeve radiotevizive.

d) Prodhon me porosi nga shfrytëzimi i arkivit të RTV-së.

dh) Vë në dispozicion, kundrejt pagesës, kapacitetet e lira të prodhimit e të transmetimit për të tretë, në formë shërbimesh, kundrejt detyrimeve kontraktore.

e) Kryen shërbime teleteksi.

ë) Ka të drejtë të botojë revista dhe materiale të ndryshme propagandistike, për promovimin e

programeve të radios e të televizionit, si dhe libra profesionale dhe të gjinive të tjera, me interes publik.

Neni 50

1. Detyrimet e RTSH-së për institucionet shtetërore publike e privatë janë përcaktuar në nenet 80 deri 83 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë".

2. Ndaj institucioneve shtetërore publike dhe private, RTSH-ja, është e detyruar që për drejtimit themelore të veprimtarisë së vet të sigurojë transparencë të plotë, duke vënë në dispozicion të të interesuarve vendimet përkatëse të strukturave drejtuese ose informacion tjetër për ecurinë e punëve.

3. Në shërbim të publikut RTSH-ja vë në qarkullim një botim periodik, ku të paktën çdo 6 muaj publikohen të dhëna të hollësishme për situatën financiare të institucionit dhe të dhëna testuese që opinioni ka për veprimtarinë programore të RTSH-së.

KREU IX PRONËSIA E RTSH-SË

Neni 51

1. E gjithë pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme, që në çastin hyrjes në fuqi të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" ka qenë në përdorim të RTSH-së, është në pronësi të saj.

2. Pasuria e paluajtshme e RTSH-së përfshin:

a) ndërtesat, sipas projekteve përkatëse, gjithë sipërfaqen e tokës së rrethuar, ku janë objektet e RTSH-së;

b) MCR-në;

c) kullat metalike të stacioneve dhe të përsëritësve televizivë;

ç) përsëritësit televizivë, që sigurojnë transmetimin e programeve televizive të TVSH-së;

d) çdo pasuri tjetër që është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me truallin e RTSH-së.

3. Pasuria e luajtshme e RTSH-së përfshin:

a) pajisjet teknike;

b) automjetet;

c) pajisjet e zyrave;

ç) materialet arkivore të filmit, të fonotekës dhe të dokumentacionit shkresor.

4. Është pronë ekskluzive e RTSH-së çdo program i prodhuar nga strukturat e saj, me porosi të RTSH-së dhe që ka siglën e këtij institucioni.

Neni 52

1. Pronat e RTSH-së mund të jepen me qira. Drejtorët e strukturave përbërëse të RTSH-së kanë të drejtë të propozojnë dhënien me qira të pronave.

2. Të gjitha pronat e paluajtshme regjistrohen në hipotekë, sipas dispozitave ligjore.

3. Me vendime të veçanta të organit përgjegjës dhe sipas legjislacionit në fuqi bëhet nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i pasurisë së luajtshme.

Neni 53

1. RTSH-ja administron dhe ruan vetë përsëritësit televizivë, që sigurojnë transmetimet e programeve të veta televizive, që mbulojnë një zonë të banuar, fshat ose lagje qyteti, me jo më pak se 3000 banorë.

2. Pushteti vendor, bashkitë dhe komunat, pasi lidhin më parë një kontratë me RTSH-në, marrin në ruajtje përsëritësit televizivë, që transmetojnë programet e RTSH-së dhe që mbulojnë një zonë të banuar me më pak se 3000 banorë.

3. RTSH-ja organizon në të gjithë vendin, me shpenzimet e saj, mirëmbajtjen e përsëritësve televizivë, që sigurojnë transmetimin e programeve të veta televizive.

KREU X BURIMET E FINANCIMIT TË RTSH-SË

Neni 54

1. RTSH-ja i siguron fondet financiare për nevojat e veta nga burimet e përcaktuara në ligj, si dhe nga burimet e mëposhtme:

- a) Shërbimet audiovizuale me pagesë për publikun.
 - b) Shitja e pasurive të luajtshme të RTSH-së.
 - c) Vënia në dispozicion për të tretët dhe me pagesë e godinave dhe e kullave metalike, e stacioneve dhe përsëritësve televizivë, kundrejt kontratave dypalëshe, e të operatorëve të tjerë që punojnë në fushën e telekomunikacioneve si:
 - operatorët publikë ose privatë të shërbimit fiks dhe të lëvizshëm telefonik;
 - operatorë strategjikë shtetërorë;
 - operatorë të tjerë shtetërorë, publikë e privatë.
 - ç) Shërbimet ndihmëse për të tretët, si punime dekorativë e riparim automjetesh.
 - d) Dhënie me qira të pajisjeve, pronë e RTSH-së, mbështetur në kontratat dypalëshe.
 - dh) Shërbime të tjera, si prodhim, montim e transmetim programesh për të tretë, vendas dhe të huaj.
 - e) Shfrytëzimi i studiove radiotelevizive, fikse dhe të lëvizshme, në favor të të tretëve vendas dhe të huaj.
 - ë) Shfrytëzimi i tokave të radiostacioneve me valë të mesme dhe të shkurtra, për qëllime fitimi.
 - f) Shërbime teleteksi.
 - g) Burime të tjera të përmendura nga neni 115 deri në nenin 118, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë".
2. Tarifat e shërbimeve miratohen me votim të hapur, me shumicën e dy të tretave të votave nga Bordi i Administrimit dhe Këshilli Drejtues.

Neni 55

1. Buxheti i shtetit financon:
- a) shërbimin e Radios për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;
 - b) shërbimin e Radios për publikun e huaj (në gjuhë të huaj) ;
 - c) shërbimin televiziv për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;
 - ç) projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja për prodhim dhe transmetim;
 - d) projekte të rëndësishme prodhimi filmik ose veprimtari artistike të mëdha mbarëkombëtare;
 - dh) orkestrën simfonike të RTSH-së dhe të kinematografisë.
2. Masa e financimit përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit.

Neni 56 **Reklama**

1. Reklama, kushtet, forma, kohëzgjatja, reklamata e ndaluara përcaktohen në nenet 49 deri 58 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion e televizionin publik e privat, në Republikën e Shqipërisë".

2. Reklama porositet nga agjenci, individë, si dhe subjekte të tjera publike e private, vendas dhe të huaj.

3. Marrëdhëniet me kontraktuesit përcaktohen në aktmarreveshjet tip, dhe ndryshojnë në varësi të nivelit të tregut të reklamës.

4. Me propozimin e Drejtorit të Marketingut, Bordi i Administrimit përcakton kriteret dhe tarifat bazë të reklamës, si dhe të kohës tregtare të cilat ia paraqet për miratim Këshillit Drejtues. Këshilli Drejtues bën përcaktimin e nocionit “kohë tregtare”.

5. Përcaktimi dhe ndryshimi i tarifave të reklamave, sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli Drejtues dhe sipas kohëzgjatjes së tyre e orareve të transmetimit, me propozimin e Drejtorisë së Marketingut dhe pas marrjes së mendimit nga Bordi i Administrimit, miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

6. Ndryshimi i tarifave të reklamës duhet të sjellë rritje të të ardhurave.

7. Drejtoria e Televizionit Shqiptar, Drejtoria e Radio Tiranës dhe radiot vendore hyjnë në marrëveshje me Departamentin e Programacionit të Radios dhe të Televizionit, për të përcaktuar kohën televizive që do të vihet në dispozicion të reklamës sipas limiteve të shprehura në Rregulloren e Brendshme të RTSH-së.

Neni 57

1. Spoti reklamues nuk mund të zgjasë me tepër se 30 sekonda.
2. Njësia matëse për spotin është çmimi në vlerë monetare për sekondë.
3. Spotet me interes publik jotregtar, që nuk reklamojnë veprimtaritë fitimprurëse, mund të zgjasin deri në 60 sekonda. Këto futen në transmetim me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 58

1. Çdo komision i paguar një agjenti duhet të jetë oferta më e ulët e Drejtorisë së Marketingut, por në çdo rast jo me e madhe se 10 për qind e vlerës së kontratës së reklamës.

2. Format e pagesës për reklamën janë cash, me llogari ose çek bankar dhe në natyrë. Kur bëhet me shkëmbim në natyrë, porositësi është i detyruar të paguajë në lekë detyrimin e taksës së TVSH-së. Shkëmbimi bëhet me kontratë të veçantë.

Neni 59

Sponsorizimi

Sponsorizimi rregullohet në mbështetje të neneve 59 deri 63 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, sipas kontratave të lidhura ndërmjet sponsorizuesit, i cili mund të jetë çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj dhe RTSH-së.

Neni 60

Dhurimet

Dhurimet që i bëhen RTSH-së nga persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, rregullohen me kontratë pa kushte.

KREU XI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 61

1. Ndryshimet në statut bëhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me propozimin e Këshillit Drejtues.

2. Në mbështetje e për zbatim të këtij Statuti hartohen rregulloret e brendshme të të gjitha strukturave organizative të RTSH-së.

Neni 62

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Kuvendit nr.402, datë 10.3.1999

"Emërimi dhe shkarkimi i stafit drejtues të RTSH-së".

Neni 63

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

U dorëzua për shtyp më 19.6.2000
Doli nga shtypi më 21.6.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 150 lekë